

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**ANALIZA KRAHASUESE E KURRIKULËS AKTUALE TË
ARSIMIT BAZË ME ATË TË VENDEVE TË TJERA**

**Redaktor shkencor: Stavri LLAMBIRI
Tidita ABDURRAHMANI
Alfred MULLA**

Maj, 2011

HYRJJE

“Analiza krahasuese e kurrikulës aktuale të arsimit bazë me atë të vendeve të tjera” është një punim kërkimor në dobi të rishikimit të kurrikulës sonë të arsimit bazë.

Vlerësimet më të fundit të kësaj kurrikule, të kryera nga spacialistë të huaj dhe ata vendas, pohojnë domosdoshmërinë e rishikimit të thellë dhe të gjithanshëm të saj dhe parashtrajnë rekomandime të rëndësishme për reformimin e strukturës së kurrikulës, për ndryshime esenciale në raportin ndërmjet kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje, në kurbën e integritit lëndor, po ashtu për sa i përket vendimmarrjeve në hartimin dhe zbatimin e kurrikulës etj.

Ky studim realizohet si veprimtari e programit “Cilësi dhe barazi në arsim” dhe është përgatitur nga Grupi Teknik, i ngritur me urdhër të Ministrit të Arsimit e Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, dhe nga specialistë të tjerë të Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA).

Analiza shqyrton kurrikulën e arsimit bazë të 14 shteteve bashkë me Shqipërinë. Këto shtete janë: Anglia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Irlanda (Republika), Italia, Kanadaja, Kosova, Korea (Republika), Polonia, Sllovenia dhe SHBA. Kjo përzgjedhje erdhi pas shqyrtimit të një numri të madh shtetesh sipas disa kriteresh si ngjashmëria në strukturën e arsimit bazë (kohëzgjatja në vite në tërësi dhe sipas dy niveleve të saj, arsimit fillor dhe arsimit i mesëm i ulët), rezultatet mbi mesataren në PISA, mundësia për të siguruar informacione të hollësishme deri në zbatimin e kurrikulës në klasë, konteksti socio-politik. Sugjerimet e ekspertëve të huaj gjithashtu përcaktuan përfshirjen e disa shteteve.

Analiza krahasuese është realizuar me anë të *desk research*, duke u bazuar në raporte studimore dhe artikuj të viteve të fundit nga burime informacioni si: *Eurydice* – Information on Education Systems and Policies in Europe (Executive Agency Education, Audiovisual & Culture), *INCA* - International Review of Curriculum and Assessment Frameworks Internet Archive (Qualifications and Curriculum Development Agency), si edhe biblioteka elektronike e *IBE* - International Bureau of Education (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization - UNESCO). Grupi i punës është konsultuar, gjithashtu me dokumente kurrikulare të shteteve të ndryshme..

Nga analiza dalin në pah dy konstatime kryesore: Kurrikulat e vendeve të ndryshme përshkohen nga të njëjtat parime themelore dhe, për rrjedhojë, kanë ngjashmëri për sa i përket pritshmërisë ndaj nxënësve, strukturës së kurrikulës, praktikave kryesore të procesit të mësimdhënie-nxënies dhe të vlerësimit të nxënësve. Nga ana tjetër, secili vend ka origjinalitetin e vet në zbatimin e këtyre parimeve kryesore sipas veçorive të traditës arsimore, kulturës dhe mundësive të suksesit të reformave kurrikulare.

Rishikimi i kurrikulës sonë të arsimit bazë synon pikërisht të kombinojë modernizimin e saj sipas parimeve të përbashkëta të vendeve të zhvilluara dhe të realizojë një përafrim të përshkallëzuar me vendet që kanë arritur të shquara arsimore duke pasur mirë parasysh rrethanat tona.

Kjo analizë u vlen në radhë të parë specialistëve të cilët po përvijojnë kurrikulën e rishikuar të klasave 1-9, gjithashtu Grupit Qendror i cili shqyrton posaçërisht vizionin e kurrikulës së rishikuar dhe pritshmërinë për formimin e nxënësve. Analiza është burim i vyer informacioni edhe për grupet e fushave të të nxënësve.

Ky studim përmban tri pjesë: analiza e kurrikulës së shteteve të përzgjedhura, analiza më e detajuar e kurrikulës aktuale të arsimit tonë bazë dhe një concept paper që paraqet përmbledhtas drejtimet kryesore të rishikimit të kurrikulës sonë.

Kurrikula e shteteve është analizuar sipas disa çështjeve që janë vlerësuar si më thelbësoret. Këto janë: Struktura e sistemit arsimor, fushat e të nxënësve, kurrikula bërthamë, kurrikula me zgjedhje, aftësitë ndërkurrikulare, temat ndërkurrikulare dhe orientimi profesional. Këto përbëjnë shtatë kapitujt e analizës krahasuese.

Secili kapitull ndahet, në përgjithësi, në tri nivele të detajimit. Tek “Abstrakti” përshkruhen mjaft përmbledhtas gjetjet tipike nga krahasimi i kurrikulave, ndërsa te “Analiza sipas shteteve” përshkruhen karakteristikat e kurrikulës së secilit shtet. Për disa nga shtatë çështjet e sipërpërmendura janë vendosur në fund të studimit të dhëna më të hollësishme për secilin shtet.

PËRMBAJTJA

AKRONIME DHE PËRKUFIZIME

PJESA E PARË: “ANALIZA SIPAS SHTETEVE”

KAPITULLI 1: “VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM”

KAPITULLI 2: “FUSHAT E TË NXËNIT”

KAPITULLI 3: “KURRIKULA BËRTHAMË”

KAPITULLI 4: “KURRIKULA ME ZGJEDHJE (KZ)”

KAPITULLI 5: “AFTËSITË NDËRKURRIKULARE”

KAPITULLI 6: “TEMAT NDËRKURRIKULARE”

KAPITULLI 7: “ORIENTIMI NË KARRIERË”

PJESA E DYTË: “ANALIZA E KURRIKULËS AKTUALE 1-9”

PJESA E TRETË: “CONCEPT PAPER”

PJESA E DYTË: “SHTOJCAT”

AKRONIME

AB - Arsimi bazë
AF - Arsimi fillor
AMU - Arsimi i mesëm i ulët

PËRKUFIZIME

“Kurrikula” është tërësia e veprimtarive të organizuara nga institucioni arsimor për të siguruar një formim të caktuar të nxënësit.

“Kurrikula bërthamë” është kurrikula e përbashkët për të gjithë nxënësit e një klase.

“Korniza kurrikulare” është dokumenti themelor i kurrikulës ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, aftësitë e temat ndërkurrikulare të nxënësve, synimet e fushave të të nxënit dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënie-nxënies e të vlerësimit të nxënësve.

“Fusha e të nxënit” është zakonisht një grupim lëndësh në të cilat integrimi i koncepteve është më i mundur dhe metodat kërkimore janë më të afërta se sa në lëndët e tjera.

PJESA E PARË: “ANALIZA SIPAS SHTETEVE”

KAPITULLI 1: “VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM”

Yllka Spahiu, Ines Todhe, Majlinda Hala

ABSTRAKT

Struktura e sistemeve të arsimit bazë në të gjitha shtetet përbëhet nga nivele të njëjta: arsimit fillor (niveli i parë i arsimit bazë) dhe arsimit mesëm i ulët (niveli i dytë i arsimit bazë), ndërsa shtrirja e tyre sipas moshës dhe klasave nuk është e njëjtë. Struktura e arsimit bazë 6+3, 5+4 ose 4+4 dhe zgjat nga 6/7 vjeç deri në 15/16 vjeç.

Kohëzgjatja tipike e arsimit bazë është 9 vjet (Angli, Finlandë, Francë, Irlandë, Kanada, Kore, Kosovë, Poloni, Slloveni, Shqipëri). Ndërsa në Itali dhe SHBA është 8 vjet, në Greqi dhe Gjermani është 10 vjet.

Organizimi i vitit, javës, ditës, orës mësimore varet nga niveli i autonomisë së shkollës. Në Angli, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Irlandë dhe SHBA shkollat kanë shkallë të madhe autonomie.

Viti shkollor zakonisht ndahet në 2 semestra ose në 3-6 periudha mësimore. Kohëzgjatja e vitit mësimor përcaktohet nga numri i javëve mësimore (30-40).

Java mësimore zgjat kryesisht pesë ditë, kurse dita mësimore zgjat 3-4 orë në arsimin fillor dhe shkon deri në 5 orë në arsimin e mesëm të ulët.

Ora mësimore në Irlandë zgjat nga 30 minuta në arsimin fillor deri në 60 minuta në arsimin e mesëm të ulët në Finlandë dhe Itali.

Të gjitha shtetet kanë kurrikulë, të miratuar në nivel kombëtar ose lokal. Vërehet një prirje e theksuar drejt rritjes së fleksibilitetit lokal sipas një plani mësimor të përcaktuar në nivel qendror.

Në shumicën e kurrikulave rritet roli i aftësive ndërkurrikulare dhe, në disa raste, zvogëlohet përshkrimi i përmbajtjes.

Kurrikula në të gjithë shtetet strukturohet në kurrikulë bërthamë dhe me zgjedhje dhe në shumicën prej tyre organizohet sipas fushave të të nxënit. Edhe në shtetet që tradicionalisht kanë patur një kurrikulë me bazë lëndësh, vërehet prirja e integritit të tyre.

Në kuadër të decentralizimit të kurrikulës, shkollave u krijohen hapësirat e nevojshme për të modifikuar kurrikulën kombëtare ose për të shtuar lëndë të reja për plotësimin e nevojave dhe interesave të komunitetit shkollor dhe lokal.

Në të gjitha shtetet vërehet një prirje e theksuar për reforma të vazhdueshme dhe me spektër të gjerë, që përfshijnë qeverisjen, menaxhimin, organizimin, përmbajtjen dhe vlerësimin e të nxënit.

Ndryshimet në politikat arsimore shpesh marrin shkas nga rezultatet e vrojtimeve ndërkombëtare, si TIMSS dhe PISA.

Në të gjitha shtetet vërehet rritja e shpeshtësisë së rishikimit të kurrikulës për t'iu përshtatur ndryshimit të nevojave. Mënyra e rishikimit është e ndryshme: e vazhdueshme sipas elementeve të kurrikulës (Kanada, Angli, Irlandë, SHBA), periodike (Itali çdo 3 vjet, Kore çdo 5-10 vjet) dhe e papërcaktuar (Francë, Gjermani).

Zbatimi i kurrikulës së rishikuar bëhet në mënyra të ndryshme. Ai mund të përfshijë të gjitha klasat (Angli) ose të bëhet me faza, sipas klasave (Francë, Irlandë, Kore).

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

Struktura e sistemeve të arsimit bazë

Arsimi fillor

Arsimi fillor është i detyruar në të gjitha shtetet. Moshë e fëmijëve në arsimin fillor është 5/6 deri 11/12 vjeç në shumicën e shteteve. Moshë tipike e nisjes së arsimit fillor është 6 vjeç, mosha më e vogël 5 vjeç (Angli) dhe më e madhe 7 vjeç (Finlandë, Poloni).

Kohëzgjatja e arsimit fillor varion nga 4 vjet (Gjermani, SHBA), në 5 vjet (Francë, Itali, Kosovë, Shqipëri) dhe 6 vjet (Angli, Finlandë, Greqi, Republika e Irlandës, Kanada, Kore, Poloni, Slloveni).

Arsimi i mesëm i ulët

Arsimi i mesëm i ulët është i detyruar në të gjitha shtetet. Moshë e fëmijëve në arsimin e mesëm të ulët është 10-13 vjeç deri 14-16 vjeç. Moshë tipike e fillimit të arsimit të mesëm të ulët është 11 vjeç (Angli, Francë, Itali, Kosovë, ShBA, Shqipëri), mosha më e vogël është 10 vjeç (Gjermani) dhe më e madhe 13 vjeç (Finlandë, Poloni).

Kohëzgjatja e arsimit të mesëm të ulët varion nga 3 vjet (Angli, Finlandë, Greqi, Irlandë, Kanada, Kore, Poloni, Slloveni) në 4 vjet (Francë, Kosovë, ShBA, Shqipëri), 5 vjet (Itali) dhe 6 vjet (Gjermani).

Nivelet

Arsimi bazë zakonisht ndahet në dy nivele: niveli i parë (arsimi fillor) dhe niveli i dytë (arsimi i mesëm i ulët). Ka shtete që kanë një strukturë të vetme të pandarë të arsimit bazë (Kanada). Në disa shtete nivelet ndahen në nën-nivele (në SHBA, Francë, Angli).

Organizimi i kohës mësimore

Viti shkollor

Viti shkollor tipik ndahet në dy semestra ose tri periudha. Në Angli dhe Finlandë viti shkollor ndahet në 6 periudha. Një periudhë nuk zgjat më shumë se 7,5 javë mësimore.

Numri mesatar i ditëve mësimore në vit është 182, numri minimal është 170 (Kore) dhe maksimal 200 (Itali). Mesatarisht në një vit shkollor në arsimin fillor zhvillohen 820 orë. Numri minimal i orëve mësimore në vit për këtë nivel është 648 (Gjermani) dhe maksimal është 969 (Poloni).

Në arsimin e mesëm të ulët zhvillohen mesatarisht 996 orë mësimore. Numri minimal i orëve mësimore në vit për këtë nivel është 868 (Slloveni) dhe maksimal është 1140 (Finlandë).

Java mësimore

Në shumicën e shteteve java mësimore zgjat 5 ditë, nga e hëna në të premte, megjithëse në Francë dhe Gjermani, një pjesë e së mërkurës ose e gjithë dita është pushim. Në Itali dhe Gjermani ka shkolla që bëjnë mësim dhe të shtunën.

Një javë mësimore në arsimin fillor përmban mesatarisht 24 orë mësimore, numri maksimal 28,5 orë mësimore (Kore) dhe ai minimal 20 orë mësimore (Slloveni).

Një javë mësimore në arsimin e mesëm të ulët përmban mesatarisht 29 orë mësimore, numri maksimal është 31 orë mësimore (Gjermani, Kore) dhe numri minimal 24.5 orë mësimore (Angli).

Në përgjithësi mësimi zhvillohet paradite. Pasdite shkolla mund të zhvillojë veprimtari sportive, artistike dhe orë studimi. Në disa shtete ofrohet ushqim dreke në shkollë si: në Finlandë, Francë, Gjermani dhe Angli.

Ora mësimore

Në shumicën e vendeve, numri i orëve mësimore në ditë për arsimin fillor është katër. Me kalimin nga klasa në klasë, ky numër orësh shkon deri në pesë.

Ora mësimore zgjat nga 30 minuta (Irlandë) deri në 60 minuta (Finlandë, Itali).

Kurrikula

Të gjitha shtetet kanë kurrikulë zyrtare të miratuar në nivel kombëtar ose lokal. Në disa shtete, që kanë patur kurrikulë të centralizuar (Kore, Slloveni, Kosovë), vërehet prirja e decentralizimit të saj. Në disa shtete në nivel qendror hartohet korniza kurrikulare (Angli, Finlandë) dhe standardet (Amerikë, Kanada), të cilat zbatohen e përshtaten nga niveli lokal dhe shkolla.

Në të gjitha shtetet vërehet rritje e pritshmërive për të nxënëit gjatë gjithë jetës, punësimin dhe përfshirjen sociale. Rol të rëndësishëm në këtë rritje ka raporti ndërmjet aftësive dhe vëllimit të njohurive dhe informacionit që duhet të përmbajë një kurrikulë. Në shumicën e shteteve theksi vihet tek aftësitë dhe jo te një përmbajtje e detajuar.

Kurrikula në të gjithë shtetet strukturohet në kurrikulë bërthamë dhe me zgjedhje dhe në shumicën e tyre ajo organizohet sipas fushave të të nxënëit. Fushat e të nxënëit përbëhen nga lëndë të integruara dhe lëndë të veçanta. Integrimi i kurrikulës zbatohet në shumicën e shteteve (Angli, Finlandë, Itali, Francë, Kore) dhe bëhet në bazë fushe, aftësish ndërkurrikulare dhe temash ndërkurrikulare. Niveli i integrimit është më i lartë në klasat e ulëta të arsimit bazë dhe më i ulët në klasat e larta të tij. Në të gjitha klasat vërehet dukshëm integrimi i TIK-ut në kurrikulë dhe mësimdhënie-nxënie.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edukimit qytetar dhe të nxënëit të gjuhëve të huaja qysh në arsimin bazë. Edukimi qytetar është pjesë e kurrikulës në të gjithë shtetet dhe zhvillohet si lëndë e veçantë ose e integruar me theks në edukimin personal, social dhe shëndetësor. Në të gjitha shtetet zhvillohet një gjuhë e huaj e detyruar dhe në disa ofrohet më shumë se një gjuhë e huaj, por jo e detyruar.

Përgjegjësitë për zhvillimin e kurrikulës

Korniza kurrikulare, standardet dhe rezultatet e arritjes përcaktohen në nivel qendror ose lokal. Zbatimi i tyre lehtësohet nga dokumente të tjerë kurrikularë.

Në shumicën e shteteve (Angli, Francë, Irlandë, Kore, Finlandë, Itali) shkollat përshtatin standardet dhe udhëzimet e nivelit qendror në programe shkollore, sipas mundësive të shkollës dhe nevojave, mundësive dhe interesave të fëmijëve.

Rezultatet e të nxëniet në përfundim të çdo niveli përcaktohen në nivel qendror, ndërsa strategjitë për arritjen e tyre përcaktohen nga shkolla. Shkolla zhvillon kurrikulën sipas nevojave të nxënësve (Francë, Angli, Irlandë, Finlandë, SHBA, Kanada). Në kuadër të decentralizimit të kurrikulës, në të gjithë shtetet shkollat nxiten të modifikojnë kurrikulën kombëtare ose të shtojnë lëndë të reja.

Rishikimi dhe zbatimi i kurrikulës së rishikuar

Në të gjitha shtetet vërehet rritja e shpeshtësisë së rishikimit të kurrikulës për t'iu përshtatur ndryshimit të nevojave. Mënyra e rishikimit është e ndryshme: e vazhdueshme, për elemente të veçanta (Kanada, Angli, Irlandë, SHBA), periodike (Itali çdo 3 vjet, Kore çdo 5-10 vjet) dhe e papërcaktuar (Francë, Gjermani).

Zbatimi i kurrikulës së rishikuar bëhet në mënyra të ndryshme. Mund të përfshijë të gjitha klasat (Angli) ose të bëhet me faza për disa klasa (Francë, Irlandë, Kore).

Shihni shtojcën 1 e cila përmban më shumë hollësi për secilin shtet:

Tabela 1: Struktura e sistemit të arsimit bazë

Tabela 2: Organizimi i kohës mësimore në arsimin bazë

Tabela 3: Numri i orëve mësimore vjetore për klasë në arsimin bazë

Tabela 4: Të dhëna të modeleve kurrikulare

KAPITULLI 2: “FUSHAT E TË NXËNIT”

Evis Mastori, Ines Todhe, Majlinda Hala, Mirela Andoni

ABSTRAKT

Kurrikulat janë të organizuara në fusha të nxëni (Irlandë, SHBA, Kore, Francë, Itali, Gjermani, Finlandë, Kosovë) ose në lëndë të veçanta (Angli, Slloveni, Poloni, Greqi).

Fusha të të nxënit në përgjithësi janë: Gjuhë, Matematikë, Shkencat natyrore, Shkencat shoqërore, Gjuhë e huaj, Artet, Edukimi fizik, Teknologjia, TIK, Edukimi fetar etj.

Këto fusha të të nxënit realizohen nëpërmjet kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje.

Fushat e të nxënit në disa shtete, sidomos në klasat e para të arsimit fillor shfaqen të integruara (Poloni, Kore), ndërsa në arsimin e mesëm të ulët, lëndët bëhen më të qarta dhe numri i tyre vjen duke u rritur.

Lëndët brenda fushave janë përgjithësisht të njëjta.

Raporti i fushave të të nxënit paraqitet i ndryshëm ndërmjet dy niveleve të arsimit bazë. Në arsimin fillor zënë mesatarisht 48% tri fusha të të nxënit: Gjuhë (23%), Matematikë (16%) dhe Shkenca natyrore (9%). Në arsimin e mesëm të ulët gati 40% të kurrikulës e zënë këto tri fusha të të nxënit: Gjuhë, Matematikë dhe Shkenca natyrore.

Në arsimin e mesëm të ulët, krahasuar me arsimin fillor, një përqindje më të madhe zë fusha: Gjuhë e huaj dhe Shkenca shoqërore (24% në arsimin e mesëm të ulët dhe 8% në arsimin fillor) dhe një përqindje më të vogël zë fusha: Arte dhe Edukimit fizik (8% në arsimin e mesëm të ulët dhe 21% në arsimin fillor).

Fushat më të përdorura janë: Gjuhë, Matematikë, Shkenca natyrore, Shkenca shoqërore, Gjuhë e huaj, Teknologji, Arte, Edukim fizik, Teknologjia e komunikimit dhe informacionit, Edukim fetar dhe etik.

Gjuhë¹

Kjo fushë përfshin lëndët: Gjuhë dhe lexim. Në disa shtete, si: Kanada, Francë, Irlandë në fushën e gjuhës përfshihet që në arsimin fillor edhe gjuha rajonale e minoritare. Greqia dhe Italia përfshijnë në këtë fushë greqishten e lashtë e moderne dhe latinishten.

Matematikë

Në të gjitha modelet kurrikulare të arsimit bazë matematika zhvillohet si fushë më vete.

Shkencat natyrore

¹ Arte të gjuhës në SHBA.

Kjo fushë përfshin lëndët: Shkenca, Biologji, Fizikë, Kimi, Shkenca e tokës dhe hapësirës, Shkenca mjedisore.

Në arsimin fillor kjo fushë integron lëndët: Kimi, Biologji, Fizikë dhe në disa raste edhe Astronomi dhe Gjeologji. Në disa shtete, fusha e teknologjisë zhvillohet së bashku me fushën e shkencës, si në Gjermani, Francë dhe Kanada. Shtete të ndryshme e emërtojnë këtë fushë në mënyra të ndryshme, si p.sh: Irlandë - Mjedisi shoqëror dhe Edukimi shkencor, Francë – Zbulimi i botës, Finlandë – Studime natyrore dhe mjedisore, Kore – Jeta inteligjente.

Fusha e shkencave në arsimin e mesëm të ulët në pjesën më të madhe të shteteve zhvillohet me lëndë të veçanta.

Shkencat shoqërore

Kjo fushë përfshin lëndët: Histori, Gjeografi, Edukim qytetar etj. Historia dhe Gjeografia janë pjesë të fushës së studimeve shoqërore për të gjitha shtetet, por kjo fushë studimi mund të përfshijë dhe Letërsinë, Qytetarinë, Edukimin shëndetësor, shoqëror dhe moral.

Anglia, Kanadaja, Polonia dhe Koreja përfshijnë në këtë fushë lëndët Histori dhe Gjeografi. Italia, Franca, Sllovenia dhe SHBA-ja përfshijnë lëndët Histori, Gjeografi dhe Qytetari. Irlanda në arsimin fillor përfshin Edukimin shoqëror, Edukimin mjedisor, Edukimin shkencor ku përfshihen lëndët Histori, Gjeografi dhe Shkencë. Gjermania në arsimin fillor përfshin lëndët Ekonomi, Studimet shoqërore, Gjeografi, Histori, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë Gjeografinë, Historinë dhe Studimet politike.

Gjuhë e huaj

Kjo fushë përbëhet nga një gjuhë e huaj. Pothuajse në të gjitha modelet e marra në studim Gjuha e huaj është lëndë e detyruar pas klasës së dytë apo të tretë të arsimit fillor, me përjashtim të Anglisë kurrikula e së cilës nuk e ofron këtë lëndë.

Teknologji

Kjo fushë përfshin lëndë të cilat japin njohuri dhe zhvillojnë shprehje për zbatimin praktik të Shkencës dhe Teknologjisë, si: punë me metal, punë me dru etj. Duhet theksuar se vendi i Teknologjisë ndryshon në kurrikula të ndryshme, kështu në disa shtete ajo grupohet me fushën e Shkencës, si në rastin e Francës, Gjermanisë, Kanadasë. Në disa shtete të tjera, si në rastin e Koresë (Teknologji dhe Ekonomi shtëpiake) dhe Anglisë (Vizatim dhe Teknologji) ajo shihet si pjesë e aftësive praktike.

Arte

Kjo fushë përfshin lëndët: Vizatim, Kërcim, Teatër, Muzikë, Art pamor, Fotografi, Histori arti, Punëdore. Në Kanada, Irlandë fusha e arteve përfshin Vizatim, Punëdore, Muzikë dhe Teatër. Në Francë kjo fushë “Praktikë artistike dhe Histori arti” përveç lëndëve të sipërpërmendura, zhvillon dhe lëndën Histori arti. Finlanda kurrikulën e artit e zhvillon së bashku me Edukimin fizik. Disa kurrikula Punëdoren e lidhin me fushën e Arteve (Kore), Teatrin me fushën e Arteve të gjuhës (SHBA) dhe Kërcimin me fushën e Edukimit fizik. Punëdoren/craft disa kurrikula e zhvillojnë dhe në fushën e Teknologjisë.

Edukimi fizik

Kjo fushë është pjesë e kurrikulës së të gjitha shteteve. Ajo përfshin lëndët: Edukim fizik, Sporte dhe në disa shtete ajo është e kombinuar dhe me lëndën Edukim shëndetësor si, në rastin e Kanadasë dhe Amerikës.

TIK²

Kjo fushë përfshin lëndët Informatikë (studime kompjuterike dhe përdorimi i bibliotekës), Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK³) ose Shkenca kompjuterike.

TIK mund të mësohet si lëndë më vete, si p.sh., në Poloni dhe Angli, ose të përdoret si lëndë e integruar ose mjet didaktik në lëndët e tjera (në Francë, Irlandë, Kanada, SHBA, Gjermani etj.)

Në disa shtete, si Angli, Irlandë, Itali, Greqi, Gjermani, Finlandë, Poloni, Slloveni, Kore, përfshihet në kurrikulat e tyre edhe Edukimit fetar dhe etik. Kjo fushë përfshin Historinë dhe parimet e njerit prej besimeve fetare. Ajo përfshin dhe lëndë të tilla si: Etika apo Filozofia, të cilat studiojnë mënyrat e sjelljes dhe jetesës së njerëzve, në përshtatje me parimet e shoqërisë. Përgjithësisht, lëndët e kësaj fushe zhvillohen nëpërmjet kurrikulës me zgjedhje.

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

ANGLIA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në 11 lëndë si më poshtë:
Anglisht, Matematikë, Shkenca, Teknologji dhe Dizenjim (*Design*), TIK, Histori, Gjeografi, Art dhe dizenjim (*Design*), Muzikë, Edukim fizik, Edukim fetar.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar në 13 lëndë si më poshtë:
Anglisht, Matematikë, Shkenca, Teknologji dhe *Dizenjim*, TIK, Histori, Gjeografi, Gjuhë e huaj, Art dhe dizenjim (*Design*), Muzikë, Qytetari, Edukim fizik, Edukim fetar (EURYDICE, 2010).

FINLANDA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në 8 fusha të të nxënit: Gjuhë amtare dhe letërsi, Matematikë, Studime natyrore dhe mjedisore, Këshillim, Arte dhe Edukim fizik, Feja dhe etika, Ekonomi shtëpiake, Gjuhë me zgjedhje.

² Fusha e TIK-ut dhe Edukimit fetar studiohet kryesisht nëpërmjet kurrikulës me zgjedhje.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar në 8 fusha të të nxënit: Gjuhët amtare dhe letërsi, Matematikë, Studime natyrore dhe mjedisore, Arte dhe Edukim fizik, Këshillim, Ekonomi shtëpiake, Gjuhë e huaj, Feja dhe etika (EURYDICE, 2010).

FRANCA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në fusha të të nxënit⁴:

Klasa e 1-rë dhe 2-të ka 6 fusha: Gjuhë frënge, Matematikë, Edukim fizik dhe sporte, Zbulim i Botës, Gjuhë e huaj, Praktikë artistike dhe Histori arti.

Klasa e 3-të, 4-ë dhe e 5-të ka 6 fusha: Gjuhë frënge, Matematikë, Edukim fizik dhe sporte, Gjuhë e huaj, Shkencat eksperimentale dhe Teknologji, Kulturë humane.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar sipas këtyre fushave:

Në klasën e 6-të kurrikula është e organizuar në 8 fusha: Gjuhë frënge, Matematikë, Gjuhë e huaj, Histori-Gjeografi-Edukim qytetar, Shkenca e tokës dhe jetës, Arte, Teknologji, Edukim fizik dhe sporte. Në klasën e 7-të dhe të 8-të kurrikula është e organizuar në 7 fusha: Frëngjisht, Matematikë, Gjuhë e huaj, Histori-Gjeografi-Edukim qytetar, Shkenca dhe teknika, Edukim artistik, Edukim fizik dhe sporte.

Në klasën e 9-të kurrikula është e organizuar në 9 fusha:

Gjuhë frënge, Matematikë, Gjuhë moderne, Histori-Gjeografi-Edukim qytetar, Shkenca e tokës dhe jetës, Fizikë dhe Kimi, Teknologji, Edukim artistik, Edukim fizik dhe sporte, (EURYDICE, 2010).

GREQIA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në 14 lëndë: Edukim fetar, Gjuhë greke, Matematikë, Histori, Studime mjedisore, Gjeografi, Shkencat natyrore, Qytetari dhe studime shoqërore, Edukim artistik, Edukim fizik, Sporte, Gjuhë e huaj e parë – Anglisht, Gjuhë e huaj e dytë.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar në 19 lëndë: Edukim fetar, Gjuhë greke e vjetër dhe letërsi, Histori, Gjuhë greke moderne dhe letërsi, Qytetari dhe studime shoqërore, Gjuhë të huaja moderne(2), Matematikë, Fizikë, Kimi, Gjeografi, Edukim Fizik, Muzikë, Arte, Ekonomi shtëpiake, Shkenca kompjuterike, Teknologji, Orientim profesional. (EURYDICE, 2010).

⁴ Në kurrikulën e Francës fushat e të nxënit i gjen me termin disiplina.

GJERMANIA (Bavaria)

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në 6 fusha të të nxënit⁵: Gjermanisht, Matematikë, Studime të përgjithshme, Gjuhë e huaj e parë, Arte, Edukim fizik, Fe.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar në 9 fusha të të nxënit: Gjermanisht, Matematikë, Shkenca natyrore, Shkenca shoqërore, Gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë, Arte, Edukim Fizik, Fe. (EURYDICE, 2010/ INCA, 2010).

IRLANDA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në 7 fusha të të nxënit: Gjuhë, Matematikë, Edukim shoqëror, mjedisor dhe shkencor, Edukim artistik, Edukim fizik, Edukim shoqëror, personal dhe shëndetësor, Edukim fetar.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar në 8 fusha të të nxëni: Gjuhë dhe letërsi, Matematikë, Shkencë dhe Teknologji, Edukim shoqëror, politik dhe mjedisor, Edukim artistik, Edukim fizik, Edukim fetar dhe moral, Këshillim dhe orientim. (EURYDICE, 2010)

ITALIA

Fushat e të nxënit⁶ në arsimin bazë janë: Gjuha dhe artet të shprehura (ku përfshihen lëndët Italisht, Gjuhë e huaj, Muzikë, Arte, Sporte), Gjeografi dhe Histori, Matematikë – Shkencë dhe Teknologji (ku përfshihen lëndët Matematikë, Shkencat eksperimentale dhe natyrore, TIK).

Lënda Edukim fetar zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje.

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në këto fusha: Gjuhë dhe Arte (ku përfshihen lëndët Italisht, Anglisht, Muzikë, Art dhe Design, Edukim fizik), Gjeografi dhe Histori (ku përfshihen lëndët Histori dhe Gjeografi), Matematikë, Shkencë dhe Teknologji (ku përfshihen lëndët Matematikë, Shkenca natyrore të zbatuara, Teknologji)

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula përfshin këto lëndë: Italisht, Matematikë, Edukim fetar, Histori-Qytetari dhe Gjeografi, Gjuhë e huaj, Kimi, Fizikë dhe Shkenca natyrore, Edukim Teknik, Arte, Muzikë, Edukim fizik. (EYRIDICE; INCA, 2010).

⁵ Në kurrikulën e Gjermanisë fushat e të nxënit i gjen me termin grupime lëndore.

⁶ Në kurrikulën e Italisë fushat e të nxënit gjenden me termin disiplina.

KANADAJA (Ontario)

Arsimi bazë përmban gjithsej 8 fusha të të nxënimit: Artet e gjuhës, Arte, Frëngjisht, Matematikë, Edukim fizik dhe shëndetësor, Shkencë dhe Teknologji, Studime sociale, Kanadaja dhe Bota. (INCA, 2010)

KOREJA

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar në fusha të të nxënimit⁷, ku në klasën e 1 – rë dhe të 2-të ato janë të integruara. Ato fillojnë të mësohen si fusha të ndara në klasën e 3-të. Kurrikula përmban gjithsej 10 fusha: Gjuhët koreane, Matematikë, Shkenca, Shkenca shoqërore, Muzikë, Edukim Moral, Arte praktike, Arte të bukura, Edukim fizik, Gjuhë të huaja (anglisht),

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar gjithashtu me bazë fushash të të nxënimit. Ajo përmban gjithsej 10 fusha: Gjuhët koreane, Edukim moral, Arte të bukura, Edukim fizik, Arte praktike, Matematikë, Shkencë, Gjuhë të huaja (anglisht), Shkenca shoqërore, Muzikë. (INCA, 2010).

KOSOVA

Në arsimin fillor kurrikula e Kosovës është e organizuar në fusha të të nxënimit. Ajo përmban gjithsej 6 fusha: Komunikimi dhe të shprehurit, Matematikë, Shkencë, Shoqëria dhe mjedisi, Shëndeti dhe mirëqenia, Jeta dhe puna.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula e Kosovës është e organizuar në fusha të të nxënimit. Ajo përmban gjithsej 6 fusha: Komunikimi dhe të shprehurit, Matematikë, Shkencë, Shoqëria dhe mjedisi, Shëndeti dhe mirëqenia, Jeta dhe puna. (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.)

POLONIA

Në arsimin fillor kurrikula ndahet në dy nën nivele arsimimi. Kurrikula në nën nivelin e parë të arsimit fillor (klasat e 1-rë dhe e 3-të) është e integruar.

Në nën nivelin e parë të arsimit fillor, në klasën e 1-rë, 2-të dhe të 3-të kurrikula organizohet mbi bazën e veprimtarive arsimore të detyruara: Mësimdhënie e integruar, Edukim fetar/etikë, orë në dispozicion të drejtorit të shkollës. Plani mësimor në nën nivelin e parë të arsimit fillor përkatësisht për klasën e 1-rë, 2-të dhe të 3-të përmban gjithsej 10 fusha: Gjuhë polake, Muzikë, Art, Studime shoqërore, Shkenca natyrore, Matematikë, Gjuhë e huaj moderne, TIK, Teknologji, Edukim fizik.

Në nën nivelin e dytë të arsimit fillor, në klasën e 4-t, 5-të dhe 6-të kurrikula organizohet në 11 lëndë si më poshtë: Gjuhë polake, Histori dhe qytetari, Gjuhë e huaj moderne, Matematikë, Shkenca natyrore, Muzikë, Art, Teknologji, Shkenca kompjuterike, Edukim fizik, Edukim fetar dhe etik.

⁷ Në kurrikulën e Koresë fushat e të nxënimit gjenden me termin grupime lëndore.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula organizohet me bazë lënde. Plani mësimor në nivelin e dytë të arsimit AMU, përkatësisht klasa e 7-të, 8-të dhe 9-të, përmban gjithsej 14 lëndë: Gjuhë polake, Histori, Edukimi qytetar, Gjuhë e huaj moderne, Matematikë, Fizikë dhe astronomi, Kimi, Biologji, Gjeografi, Arte të bukura/Muzikë, Teknologji, Shkenca kompjuterike, Edukim fizik, Edukim fetar/Etikë. (EURYDICE, 2010).

SHBA (Wiscons)

Në arsimin bazë kurrikula e Wiscons organizohet në fusha të të nxënësve, bazuar në standarde arsimore për të gjitha nivelet e arsimit të nxënësve. Fusha të të nxënësve janë 8:

Arte të gjuhës angleze (ku përfshihen studimi i Gjuhës, Letërsisë, lexim-shkrimit, dëgjimit, të folurit, Media, Teknologji e komunikimit dhe hulumtimi), Studimet shoqërore (ku përfshihen Histori, Gjeografi, Ekonomi, Shkenca politike, Qytetari, Lidhjet globale, Antropologji dhe kulturë, Sociologji, Teknologjia dhe shoqëria), Matematikë (ku përfshihen marrëdhëniet dhe veprimet me numrat, gjeometri, masat, statistika, probabiliteti dhe marrëdhëniet algjebrike), Shkenca (Shkenca e fizikës dhe e jetës dhe Shkencat mjedisore), Shëndeti, Edukimi fizik, Art, Muzikë.

Fusha e karrierës fillon në klasë të 5-të. Edukimi për mjedisin zhvillohet si lëndë e integruar duke filluar nga kopshti deri në klasën e 12-të, me theks më të madh në lëndët: Shëndeti, Shkenca dhe studimet shoqërore. TIK zhvillohet si lëndë e integruar duke filluar që në kopsht deri në klasën e 12-të. (INCA, 2010)

SLLOVENIA

Plani mësimor në klasën e 4-t, 5-të dhe 6-të përmban gjithsej 13 lëndë: Gjuhë sllovene, Matematikë, Gjuhë e huaj, Art pamor, Muzikë, Shkenca sociale, Gjeografi, Histori, Shkenca natyrore, Shkenca natyrore dhe metoda, Metoda dhe teknologji, Ekonomi shtëpiake, Edukim sportiv.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar me bazë lënde. Ajo përmban gjithsej 14 lëndë: Plani mësimor në nivelin e dytë të arsimit përkatësisht klasën e 7-të, 8-të dhe 9-të përmban gjithsej 14 lëndë: Gjuhë sllovene, Matematikë, Gjuhë e huaj, Art pamor, Muzikë, Shkenca sociale, Gjeografi, Histori, Shkenca natyrore, Shkenca natyrore dhe metoda, Metoda dhe teknologji, Ekonomi shtëpiake, Edukim sportiv. (EURYDICE, 2010)

SHQIPËRIA

Kurrikula e arsimit bazë në Shqipëri nuk është e organizuar në bazë fushash por në bazë lëndësh, kurse kurrikula e arsimit të mesëm të lartë (gjimnazi) është e organizuar në fusha të të nxënësve, ato janë: Arte, Edukim fizik dhe sporte, Gjuhë e huaj, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Karriera dhe aftësimi për jetën, Matematikë, Shkenca natyrore, Shkenca shoqërore, Teknologji.

Në arsimin fillor kurrikula është e organizuar me bazë lënde. Ajo përmban gjithsej 11 lëndë: Gjuhë amtare, Gjuhë e huaj, Matematikë, Dituri natyre, Histori, Gjeografi, Edukatë shoqërore, Edukim muzikor, Edukim figurativ, Edukim fizik dhe sporte, Mësim pune.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula është e organizuar me bazë lënde. Ajo përmban gjithsej 14 lëndë: Gjuhë amtare, Gjuhë e huaj, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Edukatë shoqërore, Edukim muzikor, Edukim figurativ, Edukim fizik dhe sporte, Kompjuter, Aftësim teknologjik. (MASH)

Shihni shtojcën 2 e cila përmban më shumë hollësi për secilin shtet:

Përshkrimi i aftësive kryesore ndërkurrikulare.

Tabela 5: Fushat e të nxënit (AF)

Tabela 6: Fushat e të nxënit (AF)

Tabela 3: Fushat e të nxënit (AMU)

Tabela 4: Fushat e të nxënit (AMU)

KAPITULLI 3: “KURRIKULA BËRTHAMË”

Aurora Guxholli, Irida Sina, Nazmi Xhomara

ABSTRAKT

Në arsimin bazë të gjitha shtetet kanë një listë lëndësh të kurrikulës bërthamë të përcaktuar në nivel qendror.

Lëndët kryesore të kurrikulës bërthamë në arsimin fillor janë: Gjuhë amtare, Matematikë, Gjuhë e huaj, Histori, Gjeografi, Shkencat natyrore, Muzikë, Arte, Edukimi fizik dhe Teknologji.

Lëndë të veçanta që hasen në disa shtete në kurrikulën bërthamë të arsimit fillor janë: Studime mjedisore, Edukim shoqëror, Edukim shëndetësor, Ekonomi shtëpiake, Punëdore dhe Fe/Etikë.

Numri i lëndëve të kurrikulës bërthamë rritet nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët. Në arsimin fillor numri i lëndëve të kurrikulës bërthamë varion nga 6-të deri në 11-të, kurse në arsimin e mesëm të ulët nga 6-të deri në 18-të.

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

ANGLIA

Arsimi bazë në Angli zgjat 9 vjet. Ai është i organizuar në faza kyçe (stages).

Arsimi fillor

Kurrikula Kombëtare në fazat kyçe I (klasat 1-2) dhe II (klasat 3-6) përmban lëndë të detyrueshme të dy llojeve, lëndë bërthamë dhe lëndë mbështetëse:

Lëndët bërthamë: Anglisht, Matematikë dhe Shkencë.

Lëndët mbështetëse: Art dhe dizejim (*Design*), Dizejim (*Design*) dhe Teknologji, Gjeografi, Histori, Tik, Muzikë, Edukim fizik, Edukim fetar (lëndë e detyruar me program të lirë).

Arsimi i mesëm i ulët

Kurrikula bërthamë në AMU (faza kyçe III) përbëhet nga lëndët e Kurrikulës Kombëtare (shih listën më sipër) dhe Edukimi qytetar, Edukimi fetar, Edukimi seksual dhe udhëzimi, Edukimi për karrierën.

FINLANDA

Shpërndarja e orëve mësimore javore në arsimin bazë

Nr.	Lënda/Klasa	1-2	3-5	6-9	Totali
1	Gjuhë amtare dhe Letërsi	14	14	14	42
2	Matematikë	6	12	14	32
3	Gjuhë e huaj I ⁸		8	8	16
4	Gjuhë e huaj II ⁹			6	6
5	Biologji dhe Gjeografi	9 ¹⁰	3	7	31
6	Fizikë dhe Kimi		2	7	
7	Edukim shëndetësor			3	
8	Histori dhe Edukim qytetar		3	7	10
9	Fe/Etikë	6	5		11
10	Muzikë	4-		3-	56
11	Arte	4-	= ¹¹	4-	
12	Aftësi praktike	4-		7-	
13	Edukim fizik	8-		10-	
14	Ekonomi shtëpiake		3		3
15	Këshillim i nxënësve		2		2
	Numri minimal i orëve	19 19	23 23 24	24 30 30 30	222

FRANCA

Arsimi bazë në Francë zgjat 9 vjet. Ai ndahet në dy nivele:

Niveli I: Arsimi fillor (klasat 1-5)

Niveli II: Arsimi i mesëm i ulët (klasat 6-9)

Arsimi fillor ndahet në dy nënnivele:

Nënniveli I (niveli bazë): klasat 1 – 2

Nënniveli II (niveli i konsolidimit): klasat 3 – 5

⁸ Gjuha e huaj I nis në klasat 1-6.

⁹ Gjuha e huaj II nis në klasat 7-9.

¹⁰ Në klasat 1-4 biologjia, gjeografia, fizika dhe kimia, sikurse edukimi shëndetësor, janë integruar në një lëndë të quajtur “Studime mjedisi dhe natyre”.

¹¹ = Lënda zhvillohet në këto klasa vetëm kur e përcakton kurrikula.

Arsimi fillor

Shpërndarja e orëve mësimore vjetore në arsimin fillor

	Fusha	Totali i orëve vjetore
Nënniveli I	Gjuhë frënge	360
	Matematikë	180
	Edukim fizik dhe sporte	108
	Zbulim i botës	81
	Gjuhë e huaj	54
	Praktikë artistike dhe Histori arti	81
	Totali (nënniveli I)	
Nënniveli II	Gjuhë frënge	288
	Matematikë	180
	Edukim fizik dhe sporte	108
	Gjuhë e huaj	54
	Shkenca eksperimentale dhe teknologji	78
	Kulturë humane	
	- Praktikë arti dhe Histori arti	78
- Histori, Gjeografi, Edukim qytetar	78	
Totali (nënniveli II)		864
Totali		1728

Arsimi i mesëm i ulët

Arsimi i mesëm i ulët në Francë zgjat katër vjet, përkatësisht klasat 6-9.

Edhe pse edukimi fetar nuk jepet si lëndë më vete në AMU, me kërkesë të Ministrit të Arsimit janë hartuar programe të reja për mësimdhënien e fesë, të cilat përforcojnë integrimin përgjatë kurrikulës.

Viti i parë i AMU-së, i njohur si niveli i përshtatjes, synon të konsolidojë arritjet e shkollës fillore dhe të ndihmojë nxënësit të mësohen me mënyrën dhe metodat e punës, të përdorura në AMU.

Vitet 2-3 (niveli i mesëm), synon të lehtësojë thellimin e njohurive dhe të mësojnë, të dinë si të nxënë.

Në vitin 4 (niveli i orientimit) nxënësit nisin të marrin Fizikë dhe Kimi.

Klasa 6 (Niveli i përshtatjes)	Fushat	Totali i orëve javore
	Gjuhë frënge	5
	Matematikë	4
	Gjuhë e huaj I	4
	Histori-Gjeografi-Edukim qytetar	3
	Shkenca e tokës dhe jetës	1.5
	Arte	
	- Arte plastike	2
	- Edukim muzikor	
	Teknologji	1.5
	Edukim fizik dhe sporte	4
Totali		26
Klasat 7-8 (Niveli i mesëm)	Gjuhë frënge	4
	Matematikë	3.5
	Gjuhë e huaj I	3
	Gjuhë e huaj II	3
	Histori-Gjeografi-Edukim qytetar	3
	Shkenca dhe teknika	
	- Shkenca e tokës dhe jetës	4.5
	- Fizikë dhe Kimi	
	- Teknologji	
Edukim artistik		
- Arte plastike	2	
- Edukim muzikor		
	Edukim fizik dhe sporte	3
Totali		26
Klasa 9 (Niveli i orientimit)	Gjuhë frënge	4.5
	Matematikë	4
	Gjuhë e huaj moderne I	3
	Histori-Gjeografi-Edukim qytetar	3.5
	Shkencat e tokës dhe të jetës	1.5
	Fizikë – kimi	2
	Teknologji	2
	Edukim artistik	
	- Arte plastike	1
	- Edukim muzikor	1
	Edukim fizik dhe sport	3
	Gjuhë moderne II (e huaj ose rajonale)	3
Totali		28.5
Totali (6-9)		80.5

GREQIA

Arsimi bazë në Greqi zgjat 9 vjet.

Kurrikula bërthamë në arsimin fillor

Shpërndarja e orëve javore për lëndë dhe klasa në arsimin fillor

Nr	Lëndët	Klasat					
		1	2	3	4	5	6
1	Edukim fetar	-	-	2	2	2	2
2	Gjuhë greke	9	9	8	8	7	7
3	Matematikë	4	4	4	4	4	4
4	Histori	-	-	2	2	2	2
5	Studime mjedisore	4	4	3	3	-	-
6	Gjeografi	-	-	-	-	2	2
7	Shkenca natyrore	3	3	3	3	2	2
8	Studime shoqërore dhe qytetare	-	-	-	-	1	1
9	Edukim artistik	3	3	3	3	2	2
10	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2
	Sporte	4	4	2	2	2	2
11	Gjuhë e huaj e parë (anglisht)	-	-	3	3	3	3
		-	-	5	5	5	5
16	Teknologji	2	2	2	2	2	2
	Totali i orëve të detyrueshme	22	22	27	27	26	26

Shpërndarja e orëve mësimore javore në arsimin e mesëm të ulët

Nr.	Lëndët	Klasat		
		7	8	9
1	Edukim fetar	2	2	2
2	Gjuhë dhe Letërsi antike greke			
	2.1 Tekste antike të përkthyer	2	2	2
	2.2 Gjuhë antike greke	3	3	3
3	Gjuhë dhe Letërsi moderne greke	3	2	2
	3.1 Mësimdhënie e gjuhës	2	2	2
	3.2 Letërsi moderne greke			
4	Histori	2	2	3
5	Studime Qytetare dhe Shoqërore	-	-	2
6	Anglisht	3	2	2
7	Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht ose Spanjisht	2	2	2
8	Matematikë	4	4	4
9	Fizikë	-	2	2
10	Kimi	-	1	1
11	Gjeografi	2	2	-
12	Fizikë	2	-	2
13	Edukim fizik	3	3	2
14	Muzikë	1	1	1

15	Arte	1	1	1
16	Ekonomi shtëpiake	1	2	-
17	Shkenca kompjuterike	1	1	1
18	Teknologji	1	1	-
19	Këshillim shkollor profesional	-	-	1
	Totali	35	35	35

GJERMANIA

Arsimi fillor

Në arsimin fillor, shkencat jepen të integruara në lëndën e studimeve të përgjithshme, kurse Arti, Muzika, Sportet dhe në shumicën e *Lände*-ve edhe feja, janë lëndë më vete. Lëndë, si: Studimet shëndetësore dhe mjedisore kanë nisur të përfshihen në kurrikulën e arsimit fillor. Në programin arsimor po përfshihen gjerësisht fusha, si: Edukim gjuhësor (inkurajimi i zhvillimit gjuhësor), Edukim matematikor (hyrje në të menduarin logjik dhe zgjidhjen e problemeve), Edukim mediatik (përdorimi i medias në mënyrë kritike), Edukim estetik (aktivitete krijuese dhe përvoja shqisore), Përdorimi i teknologjisë, Edukim për lëvizjen, Takim me gjuhët e huaja, Studime shëndetësore dhe mjedisore dhe trajtimi i natyrës dhe trupit të njeriut në mënyrë të përgjegjshme, Kultura dhe perspektiva e vendit apo rajonit të origjinës, e kombinuar me këndvështrimin ndërkombëtar.

Disa nga fushat në kurrikulën e arsimit fillor, si: Drama, Muzika etj, shpesh jepen bashkë për të gjallëruar punën sipas fokusit të temës ose kapitullit.

Lëndët e kurrikulës bërthamë në arsimin fillor janë: Gjermanisht, Matematikë, Studime të përgjithshme (përfshin hyrje në lëndë, si: Ekonomi, Studime shoqërore, Histori, Gjeografi, Shkencë (Biologji, Fizikë, Kimi etj) dhe Teknologji), Art, Muzikë, Sport, Fe.

Arsimi i mesëm i ulët

Lëndët e kurrikulës bërthamë në AMU janë:

Gjermanisht, Matematikë, Studime shoqërore, Histori, Gjeografi, Biologji, Fizikë, Kimi, Art, Muzikë, Sport, Fe, Gjuhë e huaj moderne.

Këto lëndë mund të ndryshojnë nga rajoni në rajon, megjithatë, sipas një marrëveshjeje mes Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Kulturës, programi kornizë përcakton ofrimin e disa lëndëve bërthamë (të cilat mund të ofrohen edhe me zgjedhje) në çdo lloj shkolle dhe kursi arsimor të mesëm të ulët. Këto lëndë janë: Gjermanisht, Matematikë, një gjuhë e huaj (zakonisht Anglisht), Shkenca natyrore dhe shoqërore, Muzikë, Arte, Sport.

Gjermanishtja, Matematika dhe Gjuhët e huaja zhvillohen nga 3-5 orë në javë, kurse Shkencat natyrore dhe shoqërore zhvillohen 2-3 orë në javë. Në klasën 7-të, Gjuha e huaj e dytë, e cila mund të jetë e detyrueshme ose me zgjedhje, zhvillohet nga 3-5 orë në javë.

Koha që përdoret për të zhvilluar lëndët e tjera të detyrueshme apo me zgjedhje (Muzikë, Art, Sport, Studime para-profesionale, Edukim fetar) ndryshojnë sipas tipit të shkollës, por totali duhet të mbetet 28-30 orë javore.

IRLANDA

Arsimi fillor

Fushat kurrikulare	Orë (60 minutëshe)
Mësimi laik	
Gjuhë 1 (Irlandisht)	4
Gjuhë 2 (Anglisht)	3.5
Matematikë	3
Edukim shoqëror, mjedisor dhe shkencor	3
Edukim shoqëror, personal dhe shëndetësor	0.5
Edukim fizik	1
Edukim artesh	3
Mësimi laik total	18

Arsimi i mesëm i ulët

Çdo nxënës duhet të ketë mësuar më parë secilën nga tetë fushat e identifikuara, jo domosdoshmërisht me anë të një lënde të caktuar. P.sh., Udhëheqja, këshillimi dhe kujdesi pastoral mund të jepet në një sërë lëndësh ose me anë të një lënde të vetme.

Për tri vitet e AMU-së (cikli I *junior*), nga mosha 12+ deri në 15+, nxënësit marrin fusha (të quajtura fusha përvoje): Gjuhë dhe letërsi, Studime matematikore, Shkencë dhe teknologji, Edukim shoqëror, politik dhe mjedisor, Edukim artistik, Edukim fizik-Edukim fetar dhe moral, Udhëheqje- këshillim dhe kujdes pastoral.

Numri i orëve për çdo lëndë nuk përcaktohet në nivel kombëtar. Edhe pse jepen udhëzime, vetë shkollat vendosin për orarin dhe shpërndarjen e orëve për lëndë të ndryshme.

Nxënësit në AMU studiojnë 8 lëndë për të marrë certifikatën e këtij niveli. Në raste të rralla ata mund të marrin deri në 9 ose 10 lëndë. Disa nga këto lëndë ofrohen në dy nivele (i larti dhe i zakonshmi), kurse në rastin e Irlandishtes, Anglishtes dhe Matematikës ka 3

nivele (i lartë, i zakonshëm dhe bazë). Vetëm Edukimi qytetar, shoqëror dhe politik ofrohet në një nivel të përbashkët për të gjithë.

ITALIA

Arsimi fillor

Udhëzimet (dokumenti bazë kurrikular) e ndajnë kurrikulën në disiplina të gjera; çdo disipline ka lëndë të veçanta. Mësuesve u kërkohet të bëjnë lidhje ndërmjet lëndëve, si dhe lidhje më të gjera ndërdisiplinore. Udhëzimet nuk janë përshkruese; ato nuk ofrojnë modele për planifikimin dhe vlerësimin. Për çdo lëndë përcaktohet se çfarë duhet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë në fund të çdo faze – qëllimet për zhvillimin e aftësive – dhe mësuesit udhëzohen të planifikojnë aktivitete që i ndihmojnë nxënësit për t'i arritur këto qëllime. *Objektivat e të nxënit* për çdo lëndë konsiderohen si thelbësore për arritjen e qëllimeve në fund të çdo faze.

Në të gjitha shkollat fillore jepet mësimi i fesë katolike, por ndjekja është me zgjedhje dhe ky vendim merret nga familja.

Lëndët e kurrikulës bërthamë në arsimin fillor janë: Italisht, Anglisht, Histori, Gjeografi, Matematikë, Shkencë, Teknologji dhe Teknologji informacioni, Muzikë, Arte, Edukim fizik.

Në këtë nivel nuk ka orare të përcaktuara për lëndët. Nga lëndët e kurrikulës bërthamë, vetëm Gjuha angleze ka orare:

Klasa	Nr. i orëve të Gjuhës angleze (në javë)
1	1
2	2
3	3
4	3
5	3

Numri i përgjithshëm i orëve të detyrueshme të Gjuhës angleze gjatë arsimit fillor është 396 orë.

Arsimi i mesëm i ulët

Lënda	Sasia javore	Sasia vjetore
Italisht, Histori, Gjeografi	9	297
Studime të detajuara në lëndë letrare	1	33
Matematikë dhe shkencë	6	198
Teknologji	2	66
Anglisht	3	99
Gjuhë e huaj e dytë	2	66
Art dhe dizejnim (<i>Design</i>)	2	66
Edukim fizik dhe sporte	2	66
Muzikë	2	66
	29	957

KANADAJA (Ontario)

Arsimi bazë ndahet në 3 nivele:

Niveli i parë: klasat 1 – 3

Niveli i dytë: klasat 4 – 6

Niveli i tretë: klasat 7 – 8

Kurrikula bërthamë në arsimin bazë përmban këto fusha: Artet e gjuhës (1-8), Arte (1-8), Frëngjisht (1-8), Matematikë (1-8), Edukim fizik dhe shëndetësor (1-8), Shkencë dhe teknologji (1-8), Studime shoqërore (1-6), Kanadaja dhe bota (7-8).

KOREJA

Gjatë hartimit të “Kurrikulës Kombëtare të Shtatë” (2000), theks i veçantë iu vu zhvillimit të krijimtarisë në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme. Për këtë arsye, u ul numri i lëndëve të detyrueshme në kurrikulë dhe iu dha më shumë rëndësi lëndëve me zgjedhje dhe kurrikula u hartua sipas niveleve të ndryshme të arritjes. Kështu, “Kurrikula Kombëtare e Shtatë” përbëhet nga kurrikula kombëtare e detyruar për fëmijët në klasat 1 – 10-të dhe lëndët me zgjedhje për nxënësit në klasat 11 – 12-të. Koncepti i kurrikulës së diferencuar vlen edhe për Gjuhën koreane, Anglishten, Matematikën, Shkencën dhe studimet shoqërore. Nga klasa 1-rë deri në klasën 10-të kurrikula diferencohet në bazë të aftësive akademike të nxënësit.

Sasia e lëndëve, me ndryshimet e reja pas vitit 2000, u reduktua në 30% për të inkurajuar shkollat të përshtatin kurrikulën sipas nevojave vendore dhe për t'i inkurajuar nxënësit drejt të mësuarit të vetëdrejtuar, studimeve të pavarura dhe aktiviteteve krijuese brenda shkollës. Po ashtu, dhe iu dha rëndësi e madhe Anglishtes dhe Studimit të kulturës perëndimore, në përputhje me interesin e Koresë për të qenë anëtare e komunitetit ndërkombëtar.

Në Kore Edukimi seksual është lëndë e detyruar në shkollën fillore, të mesme të ulët dhe të mesme. Prindërit nuk kanë të drejtë të mos e lejojnë fëmijën të ndjekë këtë lëndë. Edukimi seksual fokusohet në 4 drejtime: marrëdhëniet dhe identiteti gjinor, zhvillimi fizik dhe mirëqenia sipas gjinisë, mjedisi shoqëror dhe barazia gjinore, martesë dhe jeta familjare. Nxënësit në shkollën fillore mësojnë rreth shoqërisë, si të kuptojmë të tjerët, adoleshencës, lindjes, si lindin fëmijët, higjiena personale, funksionet e pjesëve të trupit, dallimet mes trupit të një të rrituri dhe një fëmije, rolet gjinore, familjet dhe si të mbrojmë veten nga sulmi.

Arsimi bazë në Kore zgjat 9 vjet dhe ndahet në dy nivele shkollimi:

Niveli I: arsimi fillor (klasat 1-6)

Niveli II: arsimi i mesëm i ulët (7-9)

Niveli I: ka tri nënnivele:

Nënniveli I: klasat 1-2

Nënniveli II: klasat 3-4

Nënniveli III: klasat 5-6

Arsimi fillor

Shpërndarja e orëve mësimore vjetore në nënnivelin I

	Fushat	Totali në orë për klasat 1 - 2	
Klasat 1-2	Gjuhë koreane	448	
	Edukim moral	80	
	Shkenca shoqërore	128	
	Matematikë	256	
	Shkencë	192	
	Arte praktike	384	
	Muzikë		
	Arte të bukura		
		Gjuhë të huaja - Anglisht	
	Totali		1496

Shpërndarja e orëve mësimore vjetore në nënlevelin II dhe III

	Fushat	Totali në orë për kl 3-4	Totali në orë për kl 5-6
Klasat 3-6	Gjuhë koreane	442	408
	Edukim moral	68	68
	Shkenca shoqërore	204	204
	Matematikë	272	272
	Shkencë	204	204
	Arte praktike	-	136
	Edukim fizik	204	204
	Muzikë	136	136
	Arte të bukura	136	136
	Gjuhë të huaja – Anglisht	68	136
	Totali		

Arsimi i mesëm i ulët

	Fushat	Totali në orë për fushë
Klasat 7-9	Gjuhë koreane	442
	Edukim moral	170
	Shkenca shoqërore	340
	Matematikë	408
	Shkencë	374
	Arte praktike	272
	Edukim fizik	272
	Muzikë	136
	Arte të bukura	136
	Gjuhë të huaja – Anglisht	340
	Totali	

KOSOVA

Shpërndarja e orëve mësimore në arsimin bazë

	Arsimi fillor	AMU
Komunikimi dhe të shprehurit	25%	20%
Matematikë	20%	15%
Shkencat	10%	15%
Shoqëria dhe mjedisi	10%	15%
Shëndeti dhe mirëqenia	15%	10%
Jeta dhe puna	10%	10%

POLONIA

Arsimi fillor

Arsimi bazë në Poloni zgjat 9 vjet dhe është i organizuar në tri nën nivele (stade).

Stadi I: klasat 1-3.

Kurrikula bërthamë e stadi I përfshin 10 fusha, të dhëna në 54 orë javore: Gjuhë polake, Muzikë, Art, Studime shoqërore, Shkenca natyrore, Matematikë, Gjuhë e huaj moderne, TIK dhe Teknologji.

Stadi II: klasat 4-6. Kurrikula bërthamë në këtë stad përfshin 9 fusha, të dhëna në 74 orë javore.

Shpërndarja e orëve mësimore javore në stadin II

Veprimtari arsimore të detyrueshme	Numri i orëve të mësimdhënies në javë për periudhën 3 vjeçare të stadii II
Gjuhë polake	16
Histori dhe qytetari	4
Gjuhë e huaj moderne	8
Matematikë	12
Shkenca natyrore	9
Muzikë	2
Art	2
Teknologji	2
Shkenca kompjuterike	2
Edukim fizik	9+3
Totali	69

Arsimi i mesëm i ulët

Stadi III. Klasat 7-9

Shpërndarja e orëve mësimore javore në stadin III

Veprimtari arsimore të detyrueshme	Numri i orëve të mësimdhënies në javë për periudhën 3 vjeçare të stadii III
Gjuhë polake	14
Histori	6
Edukimi qytetar	3
Gjuhë e huaj moderne	9
Matematikë	12
Fizikë dhe Astronomi	4
Kimi	4
Biologji	4

Gjeografi	4
Art të bukura/Muzikë	3
Teknologji	2
Studime kompjuterike	2
Edukim fizik	9+3
Totali	79

SLLOVENIA

Arsimi bazë në Slloveni zgjat 9 vjet. Arsimi bazë ndahet në tri nivele:

Niveli I: klasat 1-3

Niveli II: klasa 4-6

Niveli III: klasa 7-9

Lëndët	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Gjuhë sllovene	6	7	7	5	5	5	4	3.5	4.5
Matematikë	4	4	5	5	4	4	4	4	4
Gjuhë e huaj e parë				2	3	4	4	3	3
Arte pamore	2	2	2	2	2	1	1	1	1
Muzikë	2	2	2	1.5	1.5	1	1	1	1
Shkenca shoqërore				2	3				
Shkenca natyrore dhe metoda				3	3				
Metodë/Teknologji						2	1	1	
Ekonomi shtëpiake					1	1.5			
Histori						1	2	2	2
Gjeografi						1	2	1.5	2
Biologji								1.5	2
Edukim sportiv	3	3	3	3	3	3	2	2	2
Fizikë								2	2
Kimi								2	2
Shkenca natyrore						2	3		
Qytetari, edukim patriotik dhe etik							1	1	
Edukim për mjedisin	3	3	3						
Numri i orëve mësimore në javë	20	21	22	23.5	25.5	25.5	27/2	27.5/2	27.5/28.5

SHBA (Winsconsin)

Kurrikula bërthamë në arsimin bazë përfshin këto fusha:

- Arte të gjuhës angleze (studimi i Gjuhës, Letërsisë, Lexim-shkrimit, dëgjimit, të folurit, Media, Teknologji e komunikimit dhe hulumtimi)
- Studime shoqërore (Histori, Gjeografi, Ekonomi, Shkenca politike, Qytetari, Lidhje globale, Antropologji dhe kulturë, Sociologji, Teknologji dhe Shoqëri)
- Matematikë (marrëdhëniet dhe veprimet me numrat, gjeometri, masat, statistika, probabiliteti dhe marrëdhëniet algjebrike)

- Shkenca (Shkencën e fizikës dhe të jetës dhe shkencat mjedisore)
- Shëndeti
- Edukim fizik
- Arte
- Muzikë

SHQIPËRIA

Shpërndarja e orëve javore mësimore sipas lëndëve:

Lëndët	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Gjuhë amtare	8	8	6	5	5	5	5	5	5
Gjuhë e huaj	-	-	2	2	2	2	2	3	3
Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
Dituri natyre	-	-	2	3	2	-	-	-	-
Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
Vendlindje	-	-	-	-	2	-	-	-	-
Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	2	2	2
Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Mësim pune	1	1	1	1	1	1	1	-	-
Kompjuter	-	-	-	-	-	-	1	1	1
Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-

KAPITULLI 4: “KURRIKULA ME ZGJEDHJE” (KZ)

ABSTRAKT

Në të gjitha shtetet e marra në shqyrtim kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës në të paktën në njërin prej niveleve të arsimit bazë dhe në shumicën e shteteve në të dy nivelet.

KZ, në shumicën e shteteve, zhvillohet brenda kohës mësimore të detyruar, d.m.th. kohës mësimore të planifikuar në planin mësimor për t’u ndjekur nga të gjithë nxënësit. Në disa raste KZ ose një pjesë e KZ-së ofrohet me orë shtesë.

Koha (me numër orësh ose me përqindje) në dispozicion të KZ-së përcaktohet në planin mësimor të hartuar në nivel qendror, me përjashtim të atyre rasteve kur në planin mësimor të hartuar në nivel qendror nuk ka përcaktim orësh as për kurrikulën bërthamë. Në përgjithësi koha në dispozicion të zgjedhjes rritet nga arsimi fillor në arsimin e mesëm të ulët. Intervali në përqindje i KZ-së është 5,4% -29%.

Kurrikula me zgjedhje përbëhet nga lëndë, module dhe veprimtari krijuese.

Lista (menuja) e lëndëve të KZ-së ose përcaktohet nga autoritetet qendrore dhe u dërgohet shkollave, ose përcaktohet nga autoritetet lokale bazuar në udhëzime të dërguara nga qendra dhe u dërgohet shkollave, ose u lihet shkollave për të vendosur në përputhje me udhëzime të dërguara nga qendra ose nga autoritetet lokale.

Zgjedhja ofrohet në varësi të kushteve të shkollës dhe në bashkëpunim me prindërit dhe me nxënësit. Numri i lëndëve të ofruara nga shkolla, në disa raste, për arsye të kushteve të shkollës, është më i vogël se ai i dërguar nga qendra. Në përgjithësi larmia e ofertës për zgjedhje rritet nga arsimi fillor në arsimin e mesëm të ulët;

Larmia e KZ-së ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Vihet re që një ndër lëndët me zgjedhje që ofrohet më shpesh përgjatë të dy niveleve të arsimit bazë është Gjuha e huaj e dytë. Në një numër të konsiderueshëm shtetesh, përforcimi është pjesë e kurrikulës me zgjedhje.

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

Përshkrimi për secilin prej shteteve ka të bëjë me kohën në dispozicion, përmbajtjen dhe menaxhimin e kurrikulës me zgjedhje. Informacioni është ndarë sipas dy niveleve të arsimimit (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët) nëse është specifik për secilin dhe është dhënë për të dy nivelet nëse është i njëjtë.

ANGLIA

Si në arsimin fillor ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët kurrikula, përveç lëndëve bërthamë, përfshin edhe lëndë të tjera që i përkasin kurrikulës me zgjedhje dhe që kanë lidhje me Edukimin për karrierën, Të nxënët për punësimin, Edukimin shëndetësor dhe seksual, Gjuhët e huaja, Ndërgjegjësimin ekonomik, Edukimin mjedisor.

Në listën e lëndëve të kurrikulës kombëtare të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit ka një grup lëndësh, të cilat megjithëse bëjnë pjesë në listën e lëndëve, nuk janë të detyrueshme për t'u mësuar nga të gjithë nxënësit. Është shkolla ajo që vendos, në bashkëpunim me prindërit dhe në bazë të kërkesave të nxënësve, nëse do t'ua mësojë ose jo nxënësve të saj dhe kur do t'ua mësojë.

Shkollat kanë liri edhe në përcaktimin e orëve për secilën lëndë për të gjithë kurrikulën (bërthamë dhe me zgjedhje), por ndihmohen nga qendra me udhëzime të posaçme.

Në nivel qendror, "Departamenti për fëmijët, shkollat dhe familjet" ka hartuar udhëzimet për përgjegjësinë e shkollave për edukimin seksual dhe edukimin për drogat, alkoolin dhe duhanin duke pretenduar trajtimin e tyre jo vetëm si pjesë e kurrikulës së detyruar për shkencat, por edhe si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Këto udhëzime janë shoqëruar edhe me materialet përkatëse në formë broshurash. Planifikimi në nivel shkolle në këtë drejtim duhet të përvijohet në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës. Prindërit kanë të drejtë të vendosin për ta vazhduar ose ndërprerë edukimin seksual të fëmijëve të tyre.

Në të dy nivelet e arsimit bazë Edukimi fetar është lëndë e detyruar, por programi i saj është fleksibël. Për hartimin e tij shkollat bashkëpunojnë me autoritetet lokale të cilat nga ana e tyre janë të detyruara të ngrenë një komitet këshillimor me përfaqësues nga komunitete fetare, shoqatat e mësuesve dhe drejtues shkollash.

Në arsimin fillor

Në kurrikulën kombëtare, të hartuar nga autoritetet qendrore, lëndët të cilat nuk janë të detyrueshme për t'u mësuar nga të gjithë nxënësit janë: Qytetaria, Edukimi personal social dhe shëndetësor, Gjuhët e huaja moderne (në klasën e 5-të dhe të 6-të).

Kurrikula dhe udhëzimet përkatëse për këto lëndë janë hartuar në nivel qendror duke patur parasysh ato shkolla të cilat do ta përdorin. Kurrikula për Gjuhët e huaja është hartuar për Gjuhën frënge, Gjuhën gjermane dhe Gjuhën spanjolle.

Në arsimin e mesëm të ulët

Në kurrikulën kombëtare, të hartuar nga autoritetet qendrore, lëndët të cilat nuk janë të detyrueshme për t'u mësuar nga të gjithë nxënësit janë: Mirëqenia ekonomike dhe kapaciteti financiar, si dhe Mirëqenia personale. Kurrikula dhe udhëzimet përkatëse për këto lëndë janë hartuar në nivel qendror.

FINLANDA

Si në arsimin fillor ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët lëndët e kurrikulës me zgjedhje thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe të temave ndërkurrikulare, veçanërisht të atyre që kanë lidhje me aftësi për ekonominë shtëpiake dhe me aftësi artistike, gjithmonë duke bërë kujdes për të përmbushur dëshirat e nxënësve. Kurrikula me zgjedhje u jep mundësi nxënësve jo vetëm të thellojnë interesat e tyre, por dhe të zbulojnë interesa të reja.

Koha totale minimale për kurrikulën me zgjedhje përcaktohet në planin mësimor të arsimit bazë të hartuar nga autoritetet qendrore. Shkollave në bashkëpunim me autoritetet lokale u lihet për të bërë shpërndarjen e kohës në vite.

Nga autoritetet qendrore përcaktohen edhe 4 drejtimet kryesore për kurrikulën me zgjedhje: specializime dhe zbatime të lëndëve, module të formuara nga disa lëndë, gjuhë të huaja dhe lëndë që kanë lidhje me Teknologjinë e informacionit.

Vendimet për kurrikulën me zgjedhje merren nëpërmjet bashkëpunimit të nxënësve, shkollës dhe autoriteteve lokale të arsimit.

Jashtë orarit nxënësve u ofrohet edhe një gjuhë e huaj e nivelit A (niveli bazë), ndjekja e së cilës është me dëshirë.

Për shkak të fleksibilitetit të përcaktimit të kohës (si për kurrikulën bërthamë ashtu edhe për atë me zgjedhje), një pjesë e kohës së përcaktuar në kurrikulën bërthamë për Artet, Punimet me dorë dhe Edukimin fizik mund të përdoret për t'u ofruar nxënësve, si zgjedhje, specializime në këto lëndë.

FRANCA

Si në arsimin fillor ashtu edhe në arsimin e mesëm të ulët, edhe pse gjuha zyrtare e arsimit është Frëngjishtja, gjuhët rajonale, të tilla si Breton, Catalan, Corsican, Occitan, Basque, Alsatian dhe Flemish mund ofrohen si lëndë me zgjedhje në ato zona ku ato përdoren. Ndjekja e tyre është me dëshirë.

Arsimi fillor

Në planin mësimor përkatës të hartuar nga autoritetet qendrore nuk parashikohen orë për kurrikulë me zgjedhje.

Arsimi i mesëm i ulët

Duke filluar nga klasa e 8-të dhe 9-të, nxënësit duhet të bëjnë zgjedhje të detyruar ndërmjet një Gjuhe të huaj të dytë moderne ose një Gjuhe rajonale. Nëse ata zgjedhin Gjuhën e huaj, Gjuhët rajonale vazhdojnë të ofrohen si lëndë dhe ndiqen me dëshirë.

Duke filluar nga klasa e 7-të dhe 9-të, nxënësve u ofrohet Gjuha latine për ta ndjekur me dëshirë jashtë orarit mësimor të detyruar. Në klasën e 9-të (e cila quhet edhe cikli i orientimit) nxënësit i kërkohet të zgjedhë një ndër këto lëndë: Modul profesional, Gjuhë e huaj moderne/rajonale, Gjuhë latine/Gjuhë greke. Nëse nxënësi ka vështirësi në lëndë të caktuara, atij i lejohet të zgjedhë dyfishin e orëve të Modullit profesional dhe i hiqet ndjekja e detyruar e lëndës së Gjuhës së huaj të dytë moderne (në kurrikulën bërthamë).

GREQIA

Arsimi fillor

Në planin mësimor të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit, për kurrikulën me zgjedhje është parashikuar një sasi orësh (2-3 orë mësimore) e quajtur “zonë fleksibël për veprimtari krijuese e ndër-lëndore”. Veçori është fakti që orët në dispozicion për këtë pjesë të kurrikulës vijnë duke u zvogëluar nga njëra klasë në tjetrën (3,3,3,3,2,2).

Në klasat e 5-ta dhe 6-ta nxënësit duhet të zgjedhin brenda Gjuhës së huaj të dytë, Gjuhën frënge ose gjermane.

Po në planin mësimor janë parashikuar edhe orë (2-4) për lëndë me zgjedhje, jashtë orarit mësimor të detyruar. Veçori është fakti që orët e planifikuara në planin mësimor për këtë qëllim vijnë duke u zvogëluar (4,4,4,4,2,2). Nxënësit mund të zgjedhin nga lëndët: Arte vizuale, Drama, Muzikë, Vallëzim dhe Sport (këto të fundit vetëm për klasat e 3-ta dhe të 6-ta).

Si për zonën fleksibël ashtu edhe për zgjedhjen jashtë orarit rekomandohet të zhvillohen projekte që kanë lidhje me Edukimin mjedisor, Edukimin shëndetësor, Artin dhe Kulturën dhe që zhvillojnë të menduarit kritik e forcojnë lidhjet me komunitetin.

Për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje kërkohet bashkëpunimi i mësuesve, nxënësve, koordinatorëve përkatës në Drejtorinë Arsimore në nivel qendror, ndërsa zbatimi mbështetet nga specialistët e arsimit në nivel lokal.

Arsimi i mesëm i ulët

Në këtë nivel nxënësi duhet të mësojë dy gjuhë të huaja. Gjuha e huaj e parë e detyruar është Gjuha angleze. Nxënësit i jepet e drejta që gjuhën e huaj të dytë ta zgjedhë nga 4 gjuhë: Gjuha gjermane, Gjuha frënge, Gjuha italiane dhe Gjuha spanjolle.

Në planin mësimor të hartuar nga autoritetet qendrore nuk parashikohen orë për kurrikulë me zgjedhje.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Për nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë në disa lëndë ose për ata nxënës të nivelit të dytë të arsimit bazë të cilët dëshirojnë të përmirësojnë arritjet e tyre në lëndë të veçanta, ofrohet përforsimi. Pjesëmarrja është me dëshirë.

Në nivelin e parë përforsimi zhvillohet kryesisht për lëndën e Gjuhës dhe lëndën e Matematikës. Grupet formohen me jo më shumë se 5 nxënës dhe me rekomandimin e këshillit të mësuesve të shkollës. Programi i përforsimit zhvillohet me 2-6 orë /javë.

Në nivelin e dytë përforsimi zhvillohet kryesisht për Gjuhë, Matematikë, Fizikë, Kimi dhe Gjuhë e huaja. Grupet formohen me 5-10 nxënës. Parashikohen 1-3 orë në javë. Një nxënës mund të marrë pjesë deri në 15 orë në javë përforsim të cilat zhvillohen jashtë orarit mësimor.

GJERMANIA

Informacioni në vijim është i vlefshëm për të gjitha landet.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Edukimi fetar ofrohet si lëndë me zgjedhje në kuptimin që pjesëmarrja kryhet me dëshirën dhe vendimin e prindërve. Nëse nxënësi nuk ndjek Edukimin fetar atëherë si alternativë i ofrohet lënda e Etikës.

Për nxënësit me vështirësi në të nxënë të cilët rrezikohen të mos e kalojnë klasën, shkolla ofron orë përforsimi brenda ose jashtë orarit mësimor të detyruar. Pjesëmarrja në orët e përforsimit vendoset në bashkëpunim me nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Arsimi fillor

Si lëndë me zgjedhje ofrohen: Niveli i parë i një Gjuhe të huaj moderne (mësimdhënia dhe nxënia bëhet përmes lojës). Zgjedhja kryhet nga bashkëpunimi i shkollës me prindërit dhe nxënësit. Gjuha angleze rezulton gjuha më e zgjedhur dhe pas saj vjen Gjuha frënge.

Arsimi i mesëm i ulët

Kurrikula me zgjedhje përbëhet nga lëndë të cilat nxënësit duhet t'i zgjedhin nga një listë e ofruar nga shkolla. Lista e lëndëve dhe koha në dispozicion ndryshon në varësi të llojit të shkollës (*Hauptschule, Realschule*), por pa e kaluar totalin prej 28-30 orë /javë.

Hauptschule

Duke filluar nga klasa e 7-të, nxënësit, në përputhje me interesat e tyre, nga lista e ofruar nga shkolla duhet zgjedhin lëndë për të plotësuar 2 orë /javë.

Që nga klasa e 9-të e më tej zgjedhja bëhet 3 orë mësimore në javë dhe bëhet kujdes të përfshihen lëndë paraprofesionale (lëndë të cilat përmbajnë njohuri e aftësi të një profesioni, por që nuk pretendojnë të arrijnë një formim profesional) dhe lëndë nga Shkencat natyrore të cilat realizohen kryesisht nëpërmjet metodës së projektit.

Realschule

Duke filluar nga klasa 7-të, nxënësit, në përputhje me interesat e tyre, nga lista e ofruar nga shkolla, duhet zgjedhin lëndë për të plotësuar 3 orë /javë në përputhje me interesat e tyre. Një nga lëndët që ofrohet më shpesh është Gjuha e huaj e dytë moderne. Dy nga gjuhët e zgjedhura më shpesh nga nxënësit rezultojnë të jenë Gjuha frënge dhe Gjuha holandeze. Çdo shkollë, si lëndë të tjera ofron: Ekonomi shtëpiake, Përdorimi i kompjuterit.

ITALIA

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Shkollat kanë të drejtë të vendosin për përmbajtjen e rreth 20% të kurrikulës, por në përputhje me objektiva të posaçme të përcaktuara në nivel kombëtar. Shkollat kanë për detyrë të informojnë prindërit disa muaj përpara fillimit të vitit shkollor, për kurrikulën e detyruar dhe kurrikulën me zgjedhje, me anë të një broshure. Mësimi i fesë katolike është i garantuar nga shkolla, por ndjekja është me dëshirë dhe vendimi për ta ndjekur ose jo merret nga prindërit.

Shkollat kanë liri edhe në organizimin e orarit mësimor dhe në zgjatjen e tij me orë shtesë për të zhvilluar Gjuhë të huaja dhe Teknologji informacioni.

Shkolla mund të vendosë që një nga lëndët me zgjedhje të lirë të jetë Edukimi seksual.

Në ato shkolla ku ofrohet, janë prindërit ata që vendosin për fëmijët e tyre nëse do ta ndjekin ose jo.

Arsimi fillor

Në planin mësimor të hartuar në nivel kombëtar nuk parashikohen orë të posaçme për kurrikulë me zgjedhje.

Arsimi i mesëm i ulët

Në klasën e 8-të nxënësit mund të zgjedhin të studiojnë në vend të Matematikës (bërthamë) dhe Gjuhës gjermane (bërthamë), Matematikën e avancuar dhe Gjuhën gjermane të avancuar. Këto lëndë mund t'i zgjedhin nxënësit me rezultate të larta në këto lëndë në klasën paraardhëse.

Në klasën e 8-të nxënësit mund të zgjedhin Gjuhën frënge e cila zhvillohet me 2 orë/javë. Në këtë rast numri i orëve për këtë lëndë mundësohet duke i marrë 1 orë lëndës së Edukimit fizik dhe 1 orë zhvillohet jashtë orëve të detyruara të përcaktuara në planin mësimor.

Në klasën e 8-të nxënësit mund të zgjedhin Gjuhën latine e cila zhvillohet me 2 orë/javë. Në këtë rast numri i orëve për këtë lëndë mundësohet duke i marrë 1 orë lëndës së Gjuhës italiane dhe 1 orë zhvillohet jashtë orëve të detyruara të përcaktuara në planin mësimor.

IRLANDA

Arsimi fillor

Në planin mësimor, të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit, për kurrikulën me zgjedhje janë parashikuar 2 orë fleksibël në dispozicion të shkollës për të plotësuar nevojat dhe interesat e nxënësve dhe për t'u ofruar në përshtatje me kushtet e shkollës. Ato mund të atashohen në secilën prej 6 fushave të të nxënësve ose në ndonjë lëndë të veçantë (me përjashtim të Edukimit fetar). Mund të përdoren edhe për mësimin e një Gjuhe të huaj të dytë kur kjo e fundit është e mundur.

Planifikimi i kohës për lëndët me zgjedhje bëhet për qëllime të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. Sugjerohet të përdoret për plotësimin e një aspekti të të nxënësve në një lëndë, përforsimin e të nxënësve në një fushë të caktuar dhe realizimin e një projekti specifik.

Gjuhët e huaja që ofrohen si lëndë me zgjedhje janë: Gjuha frënge, Gjuha spanjolle, Gjuha gjermane dhe Gjuha italiane.

Me kërkesën e prindërve, nxënësi mund të mos e ndjekë lëndën e Edukimit fetar duke i dhënë në këtë mënyrë statusin e lëndës me zgjedhje.

Arsimi i mesëm i ulët

Plani mësimor parashikon për kurrikulën me zgjedhje një hapësirë fleksibël prej 17.5% të totalit të orëve e cila vihet në dispozicion të secilës prej 8 fushave të të nxënës dhe mund të përdoret për qëllime dhe në mënyra të ndryshme: Për plotësim të të nxënës në një lëndë, për nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe për zhvillimin e projekteve të veçanta.

Nxënësit, përveç lëndëve bërthamë, duhet të zgjedhin të paktën dy lëndë nga lista që përfshin: Gjuhët, Shkencat, Ekonomi shtëpiake, Studime biznesi, Muzikë, Arte, Punëdore dhe Vizatim. Me dëshirë ata mund të zgjedhin edhe 1 ose 2 lëndë të tjera nga kjo listë.

Në udhëzimet e hartuara nga qendra theksohet që secilit nxënës duhet t'i krijohet mundësia të zgjedhë një Gjuhë të dytë të huaj evropiane dhe i duhet dhënë mundësia të zgjedhë një program të Edukimit fizik.

KOSOVA

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Kurrikula me zgjedhje ka si qëllim:

- të zgjerojë dhe të thellojë lëndët e kurrikulës bërthamë
- të ofrojë lëndë dhe module të reja të cilat nuk trajtohen në kurrikulën bërthamë
- të trajtojë module me bazë temash që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore
- të krijojë mundësi për zhvillimin e kurrikulës lokale
- të nxitë të mësuarin me projekte

Për të dy nivelet si lëndë/module të reja ofrohen: Etika, Aftësi për jetën, Zgjidhja e konflikteve, TIK(në ato klasa ku nuk është pjesë e kurrikulës bërthamë), Arsimim për sipërmarrje, Edukim për të drejtat e njeriut.

Përqindja e kurrikulës me zgjedhje rritet nga 10.6% në nivelin e parë të arsimit bazë në 11.5% në klasat 5-8-të të nivelit të dytë dhe pëson një rritje të mëtejshme në klasën e 9-të me 15.6 %.

Nxënësi është i detyruar të ndjekë aq përqind të kurrikulës me zgjedhje sa është parashikuar në planin mësimor.

Në klasën e 9-të, që quhet edhe klasa orientuese, orientimet për zgjedhjen përcaktohen nga niveli qendror në planin mësimor të kësaj klase i cili gjithashtu është hartuar nga niveli qendror. Zgjedhja ofrohet përmes moduleve pasi e gjithë kurrikula e kësaj klase është e konceptuar me module (janë 10 module: Matematikë dhe TIK, Shkencat natyrore, Gjuhët, Studime shoqërore, Orientim profesional teorik, Orientim profesional praktik 1, Orientim profesional 2, Veprimtari artistike, Edukim fizik dhe sporte.

Përcaktimi në planin mësimor për kurrikulën me zgjedhje:

- Module për përforsim teorik të moduleve (1-5) të kurrikulës bërthamë dhe konkretisht për: Matematikë dhe TIK, Shkenca natyrore, Gjuhët, Studimet shoqërore, Orientim profesional;
- Module për përforsim profesional të moduleve (5-8) të kurrikulës bërthamë dhe konkretisht për: Orientim profesional teorik, Orientim profesional praktik 1, Orientim profesional 2;
- Këshillime dhe veprimtari për orientim.

Për arsimin fillor dhe për klasën e 5-të dhe të 8-të të arsimit të mesëm të ulët, përveç kohës në përqindje dhe drejtimeve të përgjithshme të kurrikulës me zgjedhje në arsimin bazë, të përcaktuara në nivel qendror, procedurat e mëtejshme për kurrikulën me zgjedhje vendosen nga shkolla në bashkëpunim me autoritetet lokale.

Për klasën e 9-të, niveli qendror, përveç kohës në përqindje, për kurrikulën me zgjedhje ka përcaktuar edhe drejtimet kryesore të kësaj kurrikule duke ua lënë shkollave dhe autoriteteve lokale detajimet e mëtejshme.

Shfrytëzimi i orëve për kurrikulën me zgjedhje të klasës së 9-të është pjesë e vendimeve të bazuara në një proces konsultativ, përfshirë nxënësit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë për arsimin.

KANADAJA (Alberta)

Arsimi fillor

Në planin mësimor të hartuar nga autoritetet arsimore të provincës, 15% e kohës mësimore është planifikuar për kurrikulën me zgjedhje, e cila përfshin dy fusha kurrikulare: Gjuhët dhe Drama. Lëndët me zgjedhje brenda këtyre fushave ndryshojnë sipas nevojave lokale dhe prioriteteve. Vendimi për lëndët me zgjedhje merret në bashkëpunim me prindërit. Në fushën e gjuhëve përfshihen edhe gjuhët për nxënësit bilingualë.

Objektivat e përgjithshme për këto fusha janë hartuar në nivel qendror. Në rastin e gjuhëve objektivat janë hartuar për disa gjuhë. Përzgjedhja e listës së gjuhëve të huaja

bazohet në nevojat e komunitetit. Shkollat mund të ofrojnë si lëndë me zgjedhje edhe Edukimin fetar ndjekja e të cilit vendoset nga prindërit. Si lëndë me zgjedhje mund të ofrohet edhe Teknologjia nëse nuk është e përfshirë në kurrikulën bërthamë të klasës përkatëse.

Arsimi i mesëm i ulët

Shkolla i ofron lëndët me zgjedhje sipas interesave të nxënësve, sipas nevojave të komunitetit dhe sipas kushteve të saj. Shkolla duhet t'i ofrojë dy nga lëndët me zgjedhje nga lista e fushave: Edukimi për karrierë dhe Edukimi teknologjik, Artet e bukura, Gjuhët e huaja, Edukimi mjedisor dhe Etika.

Objektivat e përgjithshme për këto fusha janë hartuar në nivel qendror.

Në nivel lokal mund të sugjerohen edhe lëndë të tjera me zgjedhje.

KOREJA

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës kombëtare të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit. Kurrikula me zgjedhje, në ndryshim nga modelet e tjera, në planin mësimor të hartuar në nivel qendror emërtohet “veprimtari me zgjedhje”. Veprimtaritë me zgjedhje ndahen në veprimtari që kanë lidhje me lëndën dhe në veprimtari krijuese. Veprimtaritë që kanë lidhje me lëndën kanë të bëjnë me shtimin e një lënde apo thellimin e zgjerimin e njohurive për një lëndë. Veprimtaritë krijuese mund të zgjidhen nga të gjitha lëndët dhe kanë si qëllim të nxitin të nxënësit e vetëdrejtuar. (KICE)

Koha për veprimtaritë me zgjedhje përcaktohet në planin mësimor të hartuar nga qendra. Autoritetet rajonale të arsimit janë përgjegjëse të hartojnë udhëzime dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje në shkolla në përshtatje me nevojat e shkollës dhe të nxënësve.

Shkollat, për veprimtaritë me zgjedhje, këshillohen të përdorin punën me projekte në grup, integrimin, metoda të ndryshme të të nxënësit.

Në arsimin fillor, nga autoritetet qendrore të arsimit rekomandohet që fokusi i veprimtarive me zgjedhje të jenë veprimtari krijuese.

Në arsimin e mesëm të ulët, nga autoritetet qendrore të arsimit rekomandohet që 75% e veprimtarive me zgjedhje të jenë veprimtari me bazë lëndën.

Shkolla e organizon kurrikulën me zgjedhje në funksion të kushteve të saj dhe të kërkesave të nxënësve. Nëse është e nevojshme, shkollat të cilat kanë kushte specifike mund të përdorin për orë suplementare një pjesë të orëve të kurrikulës me zgjedhje.

Nga autoritetet qendrore rekomandohet që prioritet në veprimtaritë me zgjedhje me bazë lëndën i duhet dhënë: Letërsisë kineze dhe Letërsisë klasike, TIK, Edukimit mjedisor, një gjuhë të huaj (Gjuhë gjermane, frënge, spanjolle, kineze, ruse ose arabe).

POLONIA

Lëndë me zgjedhje ofrohen në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët.

Arsimi fillor

Në klasën e 1-rë dhe të 3-të të arsimit fillor, koha në dispozicion të kurrikulës me zgjedhje përcaktohet në planin mësimor të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit dhe është 12 orë/javë si total për të tre klasat. Këto orë, nga qendra udhëzohet të përdoren për përforsim d.m.th. orë për nxënësit me vështirësi në të nxënë; për zgjerimin dhe thellimin e kurrikulës bërthamë. Një pjesë i lihet shkollës për ta vendosur sipas nevojave.

Drejtuesi i shkollës porositet që të kenë parasysh interesat e nxënësve, nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar.

Për klasat e 4-ta dhe të 6-ta koha në dispozicion të kurrikulës me zgjedhje përcaktohet në planin mësimor të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit dhe është 9 orë/javë si total për të tri klasat. Bordi i shkollës vendos për shpërndarjen e orëve për secilën klasë dhe sipas interesave të nxënësve duke ju ofruar mundësi në rritje.

Arsimi i mesëm i ulët

Edukimi fetar për të cilin janë parashikuar 6 orë/javë si total për të 3 vitet lihet në dëshirë të nxënësve për ta ndjekur. Nëse nxënësit nuk vendosin të ndjekin Edukimin fetar atëherë ata duhet të ndjekin lëndën e Etikës.

Për klasat e 7-ta dhe të 9-ta koha në dispozicion të shkollës për kurrikulën me zgjedhje përcaktohet në planin mësimor të hartuar nga autoritetet qendrore të arsimit dhe është 6 orë/javë si total për të tre klasat. Ajo mund të përdoret për zgjerimin e kurrikulës bërthamë, për lëndë të reja, për plotësimin e nevojave të veçanta (me vështirësi në të nxënë ose të talentuar) dhe për plotësimin e interesave.

SLLOVENIA

Dokumentet kurrikulare të hartuara në nivel qendror për arsimin bazë kanë të bëjnë me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje.

(MSE)Kurrikula me zgjedhje përbëhet nga kurrikula me zgjedhje brenda kohës së detyruar të mësimi dhe kurrikula me zgjedhje me orë shtesë (jashtë orëve të detyruara).

Kurrikula me zgjedhje brenda kohës së detyruar dhe me bazë lëndën nënkupton një listë lëndësh të cilën shkollat janë të detyruara t'ua ofrojnë nxënësve dhe ata duhet të zgjedhin të paktën 2 lëndë. Udhëzimet përkatëse në lidhje me listën e lëndëve dhe kurrikulat lëndore hartohen në nivel qendror. Shkollat kanë pak liri në këtë aspekt.

Kurrikula me zgjedhje me orë shtesë mund zhvillohet para ose pas orëve të detyruara mësimore. Koha për këtë kurrikulë për çdo klasë është përcaktuar në planin mësimor të hartuar në nivel qendror. Udhëzimet e dërguara nga qendra përcaktojnë si drejtime kryesore: mësim përforcues, mësim shtesë për nxënës të talentuar, studim, kryerje e detyrave të shtëpisë, veprimtari artistike, sporte. Pjesëmarrja është me dëshirë. Për planifikimin e kësaj pjese të kurrikulës shkollat bashkëpunojnë me autoritetet lokale të arsimit.

Arsimi fillor

Në planin mësimor të hartuar në nivel qendror janë planifikuar për secilën klasë orë shtesë për kurrikulën më zgjedhje.

Arsimi i mesëm i ulët

Në planin mësimor të hartuar në nivel qendror, brenda orarit të detyruar, duke filluar nga klasa e 7-të janë planifikuar për secilën klasë (3.5 orë/javë), në të cilat nxënësit ndjekin lëndë që i zgjedhin sipas dëshirave, interesave dhe talenteve. Shkollat e arsimit bazë e kanë për detyrë t'u ofrojnë nxënësve një listë lëndësh nga të cilat nxënësit duhet të zgjedhin të paktën 2 prej tyre. Është kriter i detyrueshëm që në listën e lëndëve me zgjedhje të detyruar të përfshihet një numër i caktuar lëndësh nga Shkencat shoqërore, humane, natyrore, teknike, një Gjuhë e huaj e dytë dhe Edukimi fetar.

Në planin mësimor të hartuar në nivel qendror janë planifikuar për secilën klasë edhe orë shtesë (3.5 orë/javë) për kurrikulën më zgjedhje.

SHBA(Wisconsin)

Si lëndë me zgjedhje ofrohen: Kërcim, Muzikë, Teatër dhe Artet vizuale, Familja dhe edukimin për konsumatorin, Gjuhë e huaj, Edukim shëndetësor, Edukim fizik, Arsimit bujqësor, Biznes, Edukimit mjedisor, Marketing, Edukim teknologjik.

SHQIPËRIA

Në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm të ulët

Për lëndë me zgjedhje dhe veprimtari ekstrakurrikulare në planin mësimor të arsimit bazë është lënë një hapësirë prej 1-2 orë mësimore në javë duke ua lënë shkollave të drejtën e planifikimit.

Shihni shtojcën 3 e cila përmban më shumë hollësi për secilin shtet:

Tabela 5: Përqindja e kurrikulës me zgjedhje në planin mësimor

KAPITULLI 5: “AFTËSITË NDËRKURRIKULARE”

Evis Mastori, Elona Boce, Aurela Zisi

ABSTRAKT

Në pjesën e parë të kapitullit, jepet një listë e përmbledhur e aftësive ndërkurrikulare të identifikuara nga analiza dhe ofrohet një përshkrim për secilën prej tyre. Në pjesën e dytë, paraqiten aftësitë ndërkurrikulare nga këndvështrimi i secilit shtet, duke u ndalur në vendin që zënë këto aftësi në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët si dhe lidhjen e tyre me synimet e kurrikulës së arsimit bazë.

Kurrikulat e marra në analizë janë të prirura drejt zhvillimit të të nxëniet gjatë gjithë jetës dhe mundësojnë integrimin me bazë aftësish. Ato synojnë që nxënësit të bëhen të aftë për të nxënë në mënyrë të pavarur dhe t'i përshtaten botës së punës gjithnjë e më dinamike dhe komplekse. Aftësitë ndërkurrikulare janë pjesë e rëndësishme e synimeve dhe objektivave të niveleve të arsimit, programeve lëndore, pritshmërive të të nxëniet, metodologjive të mësimdhënies dhe vlerësimit të të nxëniet.

Aftësitë ndërkurrikulare janë një faktor shumë i rëndësishëm i integritit kurrikular.

Të gjitha vendet e marra në analizë synojnë të zhvillojnë te nxënësit përmes kurrikulave të tyre aftësitë e: komunikimit, përdorimit të Matematikës, përdorimit të TIK-ut, të menduarin kritik e krijues, zgjidhjen e situatave problemore, të punuarit në grup dhe pjesëmarrjen qytetare.

Shtojca 2: Shihni përshkrimin e aftësive kryesore ndërkurrikulare.

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

Aftësitë ndërkurrikulare, në modele të ndryshme, mund të hasen të organizuara në mënyra të ndryshme. Theksi në aftësi të veçanta vihet në përputhje me politikat dhe synimet arsimore të vendit. Për këtë arsye, lista e aftësive për secilin shtet, mund të jetë e ndryshme nga lista e aftësive të dhëna në pjesën e parë të këtij materiali.

ANGLIA

Kurrikula kombëtare e Anglisë nxit zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare në të gjitha nivelet e arsimit.

Në arsimin fillor kurrikula përcakton si aftësi ndërkurrikulare:

- Aftësitë e komunikimit;
- Aftësitë e përdorimit të numrave;
- Aftësitë e përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- Aftësitë e punës me të tjerët;
- Aftësitë e përmirësimit të të nxënit dhe arritjeve;
- Aftësitë e zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç aftësive të sipërpërmendura, kjo kurrikulë nxit gjithashtu zhvillimin e aftësive të të menduarit (aftësi të përpunimit të informacionit, të arsyetimit, të kërkimit, të të menduarit krijues, të vlerësimit). Këto aftësi së bashku me aftësitë e mësipërme synojnë t'i aftësojnë nxënësit “të mësojnë si të nxënë”.

Në arsimin e mesëm të ulët aftësitë ndërkurrikulare janë të organizuara në:

- *Aftësi funksionale*, të cilat përfshijnë aftësitë e komunikimit, të përdorimit të Matematikës dhe të përdorimit të TIK. Këto aftësi zhvillohen kryesisht përmes lëndës së Gjuhës, Matematikës dhe TIK-ut si dhe përmes përdorimit të tyre në fushat e tjera të kurrikulës.
- *Aftësi personale të të nxënit dhe të menduarit*, të cilat synojnë t'i mbështesin nxënësit në procesin e tyre të të nxënit. Ato përfshijnë gjashtë grupe aftësish me anë të të cilave nxënësit bëhen:
 - Kërkues të pavarur;
 - Mendimtarë kritikë;
 - Nxënës refleksivë;
 - Pjesëmarrës në punë grupi;
 - Vetëmenaxhues;
 - Pjesëmarrës efektivë në shoqëri.

FINLANDA

Korniza kurrikulare për arsimin bazë në Finlandë është ndërtuar në bazë të konceptimit të procesit të të nxënit si “*një proces i ndërtimit të njohurive dhe të aftësive individuale dhe komunitare*”. Kurrikula kombëtare vë theksin në zhvillimin e aftësive menaxhuese të të

nxënit, të cilat konsiderohen shumë të rëndësishme për suksesin e individit në jetë. Të nxënit duhet të jetë “një proces aktiv i orientuar drejt zhvillimit të:

- Aftësive sociale
- Aftësive të të nxënit
- Aftësive të të menduarit
- Aftësive të të punuarit
- Aftësive të zgjidhjes së situatave problemore
- Aftësive të pjesëmarrjes qytetare

Theks i veçantë i vihet zhvillimit të aftësisë së përdorimit të TIK-ut përmes të gjitha lëndëve.

FRANCA

Arsimi bazë në Francë synon që nxënësit të marrin njohuri, të zhvillojnë aftësi e vlera qytetare dhe të bëjnë zgjedhje të duhura në jetë. Në përputhje me këtë synim, kurrikula kombëtare vendos tri objektiva kryesore të lidhura me zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare: zotërim i Gjuhës, zotërim i Metodave të punës, dhe Edukim qytetar dhe kulturor. Ndër prioritetet e politikave arsimore aktuale në Francë, mund të veçojmë përdorimin e TIK-ut duke e integruar në të gjitha lëndët dhe zhvillimin e aftësive profesionale përmes integritit të arsimit profesional në kurrikulën e arsimit të mesëm të ulët.

Në arsimin fillor, synimi kryesor i këtij niveli arsimimi është përfundimi i aftësive në leximshkrim (*literacy*) dhe matematikë (*numeracy*). Zhvillimi i këtyre aftësive lehtëson kalimin nga arsimi fillor në arsimin e mesëm të ulët.

Në arsimin e mesëm të ulët kurrikula synon të zhvillojë:

- Aftësi komunikuese përmes zotërimit të Gjuhës frënge, e konsideruar si baza e të gjithë edukimit, si dhe zotërimit të Gjuhës së huaj;

- Aftësi të të menduarit logjik dhe abstrakt përmes përfimit të kulturës matematikore dhe shkencore;
- Aftësi të përdorimit të Teknologjisë së informacionit;
- Aftësi për të kuptuar elementet universale dhe thelbësore të të gjithë kulturave njerëzore;
- Aftësi sociale dhe qytetare (nxënësit të mësojnë si të jetojnë së bashku dhe të nxisin ndërgjegjësimin qytetar);
- Autonominë dhe iniciativën për të qenë qytetarë të pavarur, të aftë të shohin përtej vetes dhe të përdorin aftësitë e fituara në jetën e ardhshme profesionale.

GREQIA

Korniza kurrikulare e arsimit bazë të Greqisë, e cila shpall si prioritet të nxënit gjatë gjithë jetës, synon zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Aftësi komunikuese;
- Aftësi të përdorimit të figurave dhe koncepteve matematike në jetën e përditshme;
- Aftësi për përpunimin e informacionit;
- Aftësi të bashkëpunimit me të tjerët;
- Aftësi të zgjidhjes së situatave problemore;
- Aftësi për të bërë zgjedhjet e duhura;
- Aftësi për menaxhimin e burimeve (natyrore, financiare, shoqërore);
- Aftësi krijuese;
- Aftësi të vendimmarrjes;
- Aftësi të të menduarit kritik;
- Aftësi të përdorimit të TIK-ut.

GJERMANIA

Ministrat e 16 *Lände*-ve të Republikës Federale të Gjermanisë kanë rekomanduar që arsimi fillor duhet t'u sigurojë fëmijëve njohuritë dhe aftësitë për të ardhmen. Vitet e fundit, kurrikula e Landeve ka marrë parasysh gjithnjë e më shumë konceptin e të nxënit gjatë gjithë jetës.

Arsimi fillor në Gjermani synon t'u japë nxënësve bazat për të nxënëit gjatë gjithë jetës duke u dhënë rëndësi të veçantë përmirësimit të përgjithshëm të aftësive gjuhësore dhe matematikore.

Kurrikula në arsimin fillor duhet të zhvillojë:

- aftësitë krijuese të fëmijëve;
- aftësitë e të menduarit kritik;
- aftësitë e të menduarit e pavarur;
- aftësitë e të nxënëit nga përvoja personale;
- aftësitë e të nxënëit të fakteve për të përgatitur nxënësit për jetën e përditshme;
- aftësitë e gjuhës gjermane;
- aftësitë e përdorimit të numrave dhe aftësitë matematikore;
- aftësitë në një gjuhë të huaj;
- aftësitë bazë në edukimin për kulturën, kontekstin evropian dhe botëror.

Si aspekte ndërkurrikulare evidentohen midis të tjerash, edhe nxitja e zhvillimit gjuhësor, të menduarit logjik dhe zgjidhja e situatave problemore, përdorimi i medias në mënyrë kritike, përdorimi i Teknologjisë, Gjuhët e huaja, përgjegjshmëria për natyrën dhe shëndetin.

IRLANDA

Në Irlandë, aftësitë ndërkurrikulare i referohen aftësive, strategjive dhe qasjeve që mund të përdorë nxënësi në procesin e të nxënëit. Zhvillimi i tyre nxitet në të gjitha fazat e arsimit duke qenë pjesë e synimeve arsimore dhe rezultateve të pritshme.

Në arsimin fillor, kurrikula nxit zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare në çdo fushë të nxëni. Megjithatë disa fusha janë veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e këtyre aftësive. Aftësitë e lexim-shkrimit, përfshirë aftësitë gjuhësore gojore zhvillohen në mënyrë të veçantë në lëndën e Gjuhës. Aftësitë numerike në Matematikë përfshijnë vlerësimin, zgjidhjen e problemit, parashikimin, përpunimin e informacionit etj. Aftësitë e natyrës sociale dhe personale zhvillohen në fushën e Edukimit social, personal dhe shëndetësor. Edukimi social, personal dhe shëndetësor zhvillon dhe aftësi të tjera si: analiza, mbledhja e të dhënave dhe komunikimi, vlerësimi e aftësitë kërkimore.

Zhvillimi i aftësive ndërkurrikulare në arsimin fillor përfshin:

- aftësi të të menduarit kritik: analizë, vëzhgim, vlerësim, përmbledhje, zgjidhje problemi;
- aftësi të të nxënëit: kërkim, përpunim informacioni, vlerësim;
- aftësi sociale dhe personale: aftësi të vetëdërgjegjësimit, gjetjes së zgjidhjeve, vendimmarrjes, marrjes së përgjegjësive;
- aftësi komunikuese: dëgjim, të folur dhe të shkruar;

- aftësi të përdorimit të TIK.

Theks i veçantë i vihet aftësive të të menduarit dhe aftësisë së zgjidhjes së situatave problemore.

Në arsimin e mesëm të ulët i jepet rëndësi aftësive të tilla si: komunikimi dhe përdorimi i Matematikës. Po kështu një rol të rëndësishëm në kurrikulë luajnë aftësitë për zgjidhjen e situatave problemore, vendimmarrja, të menduarit kritik. Theks i veçantë vihet në aftësinë e përdorimit të TIK-ut.

Për këtë nivel arsimimi kurrikula synon të zhvillojë:

- aftësi komunikuese;
- aftësi të përdorimit të Matematikës;
- aftësi manipuluese (të përpunimit të informacionit);
- aftësi të përdorimit të TIK;
- aftësi të të menduarit dhe të nxënësve;
- aftësi të zgjidhjes së situatave problemore;
- aftësi personale dhe ndërpersonale;
- aftësi sociale.

ITALIA

Zhvillimi i aftësive ndërkurrikulare është një nga objektivat e përgjithshme të kurrikulës së shkollës fillore siç përcaktohet nga Udhëzimet Kombëtare (*Indicazioni Nazionali*) ku theksohet në veçanti aftësia e lexim-shkrimit dhe të teknologjisë së informacionit.

Kurrikula e *shkollës fillore* vë më shumë theksin në:

- aftësitë e të nxënësve nga përvoja personale e nxënësve (mësimdhënie me nxënës në qendër);
- aftësitë e lexim-shkrimit;
- aftësitë e qytetarisë;
- aftësitë e të mësuarit të nxënësve si të mësojnë (duke kryer studime, punë në grup etj.)

Shkolla e mesme e ulët nga ana tjetër pritet që me anë të lëndëve të saj “të forcojë:

- aftësinë për të nxënë në mënyrë të pavarur;
- qëndrimet e nxënësve drejt ndërveprimit social;
- aftësitë e thelluara të TIK;
- aftësitë e zgjedhjes sipas qëndrimeve dhe prirjeve të nxënësve;
- aftësitë në përdorimin e një gjuhe të dytë të Bashkimit Europian.

Një nga synimet e reformave kurrikulare të viteve të fundit në Itali është edhe nxitja e të menduarit krijues dhe atij kritik të fëmijëve. Një udhëzues i fundit i Ministrisë së Arsimit thekson punën në grup si një mënyrë për të nxitur “iniciativën, pavarësinë dhe përgjegjësinë personale”. Nxitja e të menduarit krijues dhe kritik shprehet qartë në metodologjinë e përdorur në mësimdhënie.

Aftësitë shprehen në të ashtuquajturat *Traguardi per lo sviluppo della competenza* (synime për zhvillimin e kompetencave). Këto janë synime të cilat përcaktohen për çdo fushë të nxëni dhe duhet të përmbushen brenda përfundimit të shkollës së mesme të ulët.

KANADAJA (Ontario)

Në vizionin e ri për të nxënit *Learn Canada 2020* të shpallur në Kanada në prill 2008 nga Këshilli i Ministrave të Arsimit, përcaktohet ofrimi i mundësive për të nxënit cilësor gjatë gjithë jetës nëpërmjet arsimit fillor dhe të mesëm të ulët. Të gjithë fëmijët që ndjekin këtë sistem meritojnë mundësi mësimdhënieje dhe të nxëni që u ofrojnë atyre aftësi të rendit më të lartë:

- në lexim-shkrim;
- në përdorimin e numrave;
- në shkenca.

Ministria e Arsimit e Ontarios ka zhvilluar një kurrikulë tërësisht të re, e cila u kërkon nxënësve në të gjitha klasat e fillores të studiojnë Teknologjinë. Klasat fillore mësojnë më herët aftësitë e lexim-shkrimit dhe aftësitë matematikore. Reformat janë bërë me vizionin për t'u siguruar nxënësve në Ontario njohuritë dhe aftësitë më të fundit për të kontribuar në një ekonomi globale sfiduese dhe për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm në komunitetet përkatëse. Në përgjigje të krizës globale ekonomike, është marrë gjithashtu vendimi që, duke nisur nga viti 2011, në kurrikulën e Ontarios për klasën e 4-të dhe të 12-të të përfshihet gjithashtu edhe zhvillimi i aftësive bazë financiare (*financial literacy*).

Aftësitë ndërkurrikulare në kurrikulën e Ontarios shprehen në objektivat kryesore të kurrikulës së re. Këto objektiva përcaktojnë që nxënësit të jenë në gjendje:

- të fillojnë të lexojnë, shkruajnë dhe gërmëzojnë në një moshë më të hershme se në të kaluarën;
- të zhvillojnë aftësi më të mprehta për zgjidhjen e situatës problemore;
- të jenë më të përgatitur se më parë për shkollën e mesme (arsimin e mesëm të lartë, 14 vjeç e lart).

Aftësitë ndërkurrikulare në kurrikulën e Ontarios përcillen përmes përmbajtjes dhe pritshmërive të saj. Në të gjitha lëndët specifikohet që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e lexim-shkrimit, përdorimit të numrave dhe aftësitë e mendimit kritik. Pjesë e vlerësimit të nxënësit është edhe vlerësimi i aftësive të të nxënit dhe i shprehive të tilla, si: përgjegjshmëria, organizimi, puna e pavarur, bashkëpunimi, iniciativa dhe vetëmenaxhimi.

KOREJA

Filozofia e kurrikulës së arsimit bazë të Republikës së Koresë shpall si prioritet të nxënësve gjatë gjithë jetës. Sipas kësaj filozofie, arsimit bazë duhet të sigurojë për të gjithë nxënësit aftësitë bazë të të nxënësve dhe të jetës dhe kompetencat bazë për punë.

Në synimet e përgjithshme të kurrikulës së arsimit bazë përcaktohet që:

- nga të gjithë nxënësit të përvetësohen njohuritë dhe konceptet (të nxënësve për të ditur);
- tek të gjithë nxënësit të zhvillohen aftësitë e zbatimit praktik, përvojat dhe kompetencat që lidhen me punën (të nxënësve për të bërë);
- tek të gjithë nxënësit të zhvillohen aftësitë mendore (të menduarit, të arsytuarit etj.) aftësitë dhe cilësitë emocionale ndjenja krijuese/estetike, shpirti i mirëqenies, ose i njohjes së vetvetes, zbulimi dhe zhvillimi etj. (të nxënësve për të qenë);
- tek të gjithë nxënësit të edukohen qëndrime dhe vlera që e vënë theksin te toleranca, paqja, respekti për të tjerët, te harmonia shoqërore etj. (të nxënësve për të jetuar së bashku).

KOSOVA

Kurrikula e re e Kosovës është një kurrikulë e bazuar në kompetenca, të cilat përcaktohen si rezultate mësimore. Në Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës kompetencat përkufizohen si *aftësi të gjera për të zbatuar njohuri, shkathhtësi, qëndrime, rutinat, vlera dhe emocione në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.*

Kompetencat e përshkruara në këtë dokument janë:

- kompetencat e komunikimit (komunikues efektiv);
- kompetencat e të menduarit (mendimtar kritik);
- kompetencat për të mësuar (nxënës i suksesshëm);
- kompetencat për jetë, punë dhe mjedis (kontribues produktiv);
- kompetencat personale (individ i shëndetshëm);
- kompetencat qytetare (qytetar i përgjegjshëm).

Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit, të të menduarit dhe kompetencat për të mësuar janë të natyrës *funksionale*. Në Kornizën e Kurrikulumit parashikohet që vlerësimi duhet të marrë parasysh aspekte të ndryshme të kompetencave siç janë dijet, shkathhtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

POLONIA

Kurrikula e vitit 2002 e arsimit fillor përmes të tjerash synonte zhvillimin e Gjuhës, të interesave personale dhe aftësive sociale. Duke filluar që nga shtatori 2009, *arsimi fillor*

do të ketë një kurrikulë të re bërthamë që veç të tjerash do t'u mundësojë nxënësve zhvillimin e:

- aftësi për të përdorur njohuritë dhe informacionin në kryerjen e detyrave;
- aftësi për zgjidhjen e situatave problemore;
- qëndrimeve të lidhura me përgjegjshmërinë.

Në arsimin e mesëm të ulët kërkohet që nxënësit të fitojnë:

- aftësi të të lexuarit;
- aftësi të menduarit matematikor;
- aftësi të menduarit shkencor;
- aftësi të komunikimit;
- aftësi të përdorimit të TIK-ut;
- aftësi të gjetjes, përzgjedhjes dhe analizës së informacionit në mënyrë kritike;
- aftësi për të identifikuar nevojat arsimore vetjake;
- aftësi për të punuar në grup.

SLLOVENIA

Reformat kurrikulare në Slloveni në arsimin bazë kanë mundësuar integrimin në kurrikulë të:

- aftësi të lexim-shkrimit;
- aftësi të përdorimit të numrave;
- aftësi kërkuese;
- aftësi të të menduarit krijues;
- aftësi të përpunimit të informacionit;
- aftësi të arsyetimit;
- aftësi të vlerësimit;
- aftësi të komunikimit;
- aftësi të punës me të tjerët.

SHBA (Wisconsin)

Në kurrikulën e Wisconsin aftësitë ndërkurrikulare janë pjesë e standardeve kurrikulare. Në këtë model, aftësitë janë integruar brenda pesë fushave të njohurive të zbatuara:

- aftësitë e të menduarit (zgjidhja e situatave problemore, vendimmarrja, të menduarit kritik, të menduarit krijues, të menduarit analitik, aftësitë për të imagjinuar vende, kohë dhe situata të ndryshme nisur nga këndvështrimi personal, aftësitë e zhvillimit dhe të testimit të hipotezave, dhe aftësitë e transferimit të të nxënimit në situata të reja).
- aftësitë e të nxënimit në Matematikë, Shkencë, Studime shoqërore, Gjuhë, Teknologji.
- aftësia për të bërë punë me cilësi (aftësitë e përdorimit të informacionit, arritjen e rezultateve me cilësi, reflektimin mbi rezultatet dhe vendosjen e qëllimeve).
- aftësitë komunikuese (dhënia dhe mbrojtja e një argumenti, puna efektive në grup, prezantimi i planeve dhe proceseve për arritjen e qëllimeve, komunikimi përmes një shumëllojshmërie mjjetesh).
- aftësi të pjesëmarrjes në komunitet (njohjen dhe veprimin si qytetarë të përgjegjshëm, përgatitjen për botën e punës dhe të nxënimit gjatë gjithë jetës; kontribuimin në jetën kulturore dhe estetike të komunitetit; të parët e vetes dhe të komunitetit si pjesë e mbarë shoqërisë; kontribuimi dhe përshtatja ndaj ndryshimeve shkencore dhe teknologjike).

SHQIPËRIA

Kurrikula aktuale e arsimit bazë në Shqipëri, nuk përcakton në mënyrë të qartë aftësitë ndërkurrikulare që duhet të synojnë të gjitha lëndët, sepse kurrikula nuk është udhëhequr nga dokumenti i kornizës kurrikulare. Në një pjesë të programeve lëndore aktuale të klasave të 1-ra dhe të 9-ta synohet zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik e krijues, por gjenden dhe aftësi të tjera, si ajo e komunikimit, përdorimit të Matematikës, zgjidhjes së situatave problemore, të punuarit në grup, e përdorimit të TIK-ut apo aftësi sociale. Kurrikula aktuale e gjimnazit e konsideron zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare si domosdoshmëri për përgatitjen e nxënësve për jetën dhe punën në të ardhmen. Kjo kurrikulë synon zhvillimin e këtyre aftësive të:

- komunikimit,
- përdorimit të Matematikës,
- përdorimit të Teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK),
- menduarit kritik,
- menduarit krijues,
- përdorimit dhe përpunimit të informacionit,
- zgjidhjes së situatës problemore,
- punuarit në grup,
- qëndrimit etik e social.

Të gjitha programet lëndore për klasat e 10-ta dhe të 12-ta përshkohen nga këto aftësi.

KAPITULLI 6:”TEMAT NDËRKURRIKULARE”

Astrit Dautaj

ABSTRAKT

Temat ndërkurrikulare janë çështje që përshkojnë të gjithë kurrikulën. Këto tema janë pjesë e të gjitha kurrikulave të vendeve të shqyrtuara. Kurrikulat kombëtare vënë theks më të madh ose më të vogël në temat ndërkurrikulare sipas përparësive kombëtare. Për shembull, në Republikën e Koresë është temë ndërkurrikulare çështja e ribashkimit të dy pjesëve të Koresë.

Temat ndërkurrikulare përfshihen në kornizën kurrikulare dhe harmonizojnë politikat themelore kombëtare që duhet zënë vend në kurrikulë. Në këtë rast bëhet fjalë për përparësi afatgjata si për shembull: mjedisi, shëndeti etj.

Temat ndërkurrikulare hasen me terma të ndryshme si p.sh.: tema ndërkurrikulare (Spanjë, Irlandë), fusha ndërkurrikulare (Australi), fusha thelbësore të përbashkëta të nxëni (Kanada, SHBA-Winsconsin) dhe objektiva ndërkurrikulare (Hungari, Hollandë). Në disa shtete, temat ndërkurrikulare gjenden të ndërthurura me aftësitë ndërkurrikulare (Zelandë e Re, Singapor).

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

Temat e mëposhtme janë jo domosdoshmërisht të shprehura qartë në të gjitha kornizat kurrikulare. Në shumë raste ato nënkuptohen me anën e objektivave që gjenden në të gjitha fushat e të nxënit.

Angli	Sipërmarrja, zhvillimi i qëndrueshëm, qytetaria, komunikimi, shëndeti, mjedisi.
Irlandë	Identiteti irlandez, dimensionimi shpirtëror, dimensionimi global, dimensionimi evropian, pluralizmi etj.
Greqi	Kurrikula në Greqi përmban të ashtuquajturën “Zona fleksibël” që i shërben zhvillimit të temave ndërkurrikulare dhe veprimtarive krijuese.
Francë	Njohuritë dhe aftësitë që përcaktojnë qëndrimin e fëmijës si dhe aftësitë për të zhvilluar koncepte bazë si <i>koha</i> , <i>hapësira</i> , <i>metodologjia</i> e punës.
Gjermani	Zhvillimi gjuhësor, edukimi matematik (mendimi logjik dhe zgjidhja e problemit), media, shëndeti, mjedisi, këndvështrimi kulturor etj.
SHBA	Edukim moral (karakter), mjedisi, karriera.
Kore	Morali, mjedisi, shëndeti, orientimi ndaj punës, siguria, seksi, karriera, ribashkimi i Koreve.
Shqipëri	Mjedisi, shëndeti, siguria, të drejtat e njeriut, globalizmi.

KAPITULLI 7: “ORIENTIMI NË KARRIERË”

Mirela Andoni, Alqi Mustafai, Ejvis Gishti

ABSTRAKT

Në këtë kapitull paraqitet një informacion i përmbledhur në lidhje me veprimtaritë që lidhen me orientimin në karrierë në arsimin bazë. Për këtë janë analizuar të njëjtat modele kurrikulare të vendeve të ndryshme.

Në të gjitha vendet e studiuara orientimi për karrierën është pjesë integrale e kurrikulës në të gjitha nivelet e arsimit të detyruar dhe ka si qëllim, njohjen e botës së punës, orientimin për shkollim, trajnim, punësim, zhvillimin e shpirtit sipërmarrës, planifikimin dhe vendimmarrjen për karrierën, aftësimin për t'u vetëorientuar për gjatë gjithë jetës. Këto qëllime në arsimin fillor, përgjithësisht realizohen përmes veprimtarive të integruara/në fusha/disiplina/ lëndë të ndryshme. Në arsimin e mesëm të ulët shpesh realizohet si veprimtari e veçantë (klasat 7- të,8-të,9-të). Në arsimin e mesëm të ulët shoqërohet me praktika/vizita njohëse në ndërmarrje/kompani (p.sh. për 1-2 javë). Për realizimin e objektivave të kërkuara ka një bashkërendim të shkollës me institucione lokale të punës si dhe me biznesin. Veprimtaritë e këshillimit individual të nxënësve nga zyrat e këshillimit pranë shkollës shoqërojnë veprimtaritë e orientimit për karrierë që realizohen në klasë.

Edukimi për sipërmarrjen është gjithashtu pjesë e integruar e orientimit në karrierë. Realizimi i qëllimeve të edukimit të nxënësve për orientimin në karrierë është detyrë parësore e institucioneve arsimore, por krahas këtyre institucioneve një rol të rëndësishëm luajnë edhe ministrinë e punës së çështjeve sociale sipas vendeve. Roli i tyre është të lehtësojnë kalimin nga shkolla në botën e punës, zgjedhjen e karrierës së duhur, si dhe orientimin për të gjetur punë.

* * *

ANALIZA SIPAS SHTETEVE

Kur shtetet anëtare të BE-së filluan të zhvillojnë politika të përbashkëta të orientimit në karrierë, zhvilluan gjithashtu një përkufizim të përbashkët (në vitin 2004). Ky përkufizim është shpallur zyrtarisht në dokumentin “*Rezoluta e BE-së për Orientimin në Karrierë*”¹², që e përkufizon orientimin në karrierë si më poshtë:

Në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, orientimi i referohet një sërë aktiviteteve, që u mundësojnë qytetarëve të çdo moshe dhe në çdo fazë të jetës së tyre të identifikojnë kapacitetet, kompetencat dhe interesat e tyre për të marrë vendime arsimimi, aftësimi dhe profesionale dhe për të menaxhuar rrugët e jetës individuale në mësim, punë dhe fusha të tjera, në të cilat mësohen dhe përdoren këto kapacitete dhe kompetenca.

Referuar dokumenteve të BE-së termi “karrierë” shkurtimisht mund të përkufizohet si: “*Rruga e individit gjatë arsimimit dhe punës*”.

¹² Në disa dokumente të BE-së përdoret termi *orientim* në vend të *orientimit në karrierë*.

Termet *profesion* ose *punë* janë përdorur më parë në orientimin profesional¹³ pasi ishte normale që individi të zgjidhte vetëm një profesion në jetën e tij. Për shkak të ndryshimeve të shpejta në tregun e sotëm të punës njerëzve iu është dashur të ndërrojnë më shpesh vendet e punës dhe gjithashtu profesionet. Për këtë arsye, termi profesion është zëvendësuar nga termi *karrierë*.

Vende të ndryshme përdorin termin *orientim profesional* si ekuivalent të termit *orientim për karrierën*.

ANGLIA

Sipas akteve legislative, shkollat ofrojnë programe të detyruara të edukimit për karrierën në klasat 7-të deri 11-të (që i përket moshës 12-16 vjeç).

Në kurrikulën e klasës 10-të dhe 11-të (mosha 15-16 vjeç), shkolla ka detyrim gjithashtu krahas edukimit në karrierë, të përfshijë të nxëniet referuar punës (që përfshin veprimtari të planifikuara që përdorin përvojat në tregun e punës për të zhvilluar aftësi, njohuri dhe qëndrime në lidhje me punën). Këto veprimtari kanë si qëllim gjithashtu të përmirësojnë të kuptuarin për ekonominë, sipërmarrjen, financat personale, strukturën e organizimit të biznesit etj. Shkolla zhvillon edhe veprimtari që përfshijnë kontaktet me persona nga bota e punës, vizita në kompani, ndërmarrje, shërbime të këshillimit pranë shkollës, shërbime të këshillimit jashtë shkollës, zyrat e punës në të gjitha rajonet etj.

FINLANDA

Shërbimet orientimit për karrierën, janë të detyruara me ligj për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Gjatë arsimit fillor, edukimi për orientimin në karrierë realizohet në formë të integruar dhe synon orientimin e nxënësve për të qenë funksionalë në shoqëri dhe në botën e punës. Nga klasa e 7-të deri në të 9-ën, realizohet e detyruar një lëndë e veçantë për orientimin në karrierë dhe sipërmarrjen (me dy orë në javë). Për realizimin e përmbajtjes janë autoritetet vendore ose shkolla që vendos.

Në kornizën kurrikulare përshkruhet mënyra e organizimit të praktikës në punë gjatë arsimit bazë me synim familjarizimin e nxënësve me botën e punës. Në klasën e 8-të dhe të 9-të nxënësit kanë detyrimin të shpenzojnë 2 javë në punë (në biznes).

FRANCA

Edukimi për orientimin në karrierë është i detyrueshëm në arsimin bazë. Që nga viti 2004, Edukimi për karrierën zhvillohet në vitin e tretë të arsimit të mesëm të ulët. Qëllimi kryesor është

¹³ Orientimi në karrierë, në disa shtete quhet *orientim profesional*.

t'i njohë nxënësit me botën e punës dhe t'i asistojë ata në arritjen e një vendimmarrjeje lidhur me të ardhmen duke përfshirë edhe shkollimin e mëtejshëm.

Për orientimin në karrierë janë propozuar këto dy rrugë:

- Një kurs me zgjedhje për investigimin e botës së punës prej 3 orësh në javë, i cili synon t'i pajisë nxënësit me njohuritë bazë rreth botës së punës. Ai duhet të ofrohet në të gjitha kolegjet, për të gjithë nxënësit e interesuar. Rezultatet e këtij kursi merren në konsideratë edhe për certifikim.
- Një modul prej 6 orësh në javë, i destinuar për nxënësit në nevojë, dhe që dëshirojnë të kalojnë në një kurs të formimit profesional pas vitit të tretë.

Në fillim të vitit shkollor 2008-2009 për nxënësit e klasës së 5-të (mosha 12 vjeç) ofrohet lënda "Zbulim i karrierës dhe formimit profesional" e cila vazhdon deri në përfundim të gjimnazit.

Qëllimet kryesore të kësaj fushe të formalizuara në legjislacionin arsimor, përfshijnë zhvillimin e autonomisë dhe të iniciativës të nxënësit, si dhe pajisjen e tyre me kompetencat e nevojshme për t'u vetëorientuar gjatë gjithë jetës.

Në vitin e tretë të arsimit të mesëm të ulët (13 vjeç), çdo nxënës shpenzon një javë për të "vrotuar një njësi të caktuar pune", gjë që mund të realizohet edhe gjatë vitit të katërt (mosha 14 vjeç). Deri në fund të shkollimit çdo nxënës duhet të ketë kryer stazhin prej 10 ditësh në një kompani ose duke kontaktuar një person nga bota e punës.

GJERMANIA

Edukimi për orientimin në karrierë, është një komponent i detyrueshëm përmbajtjesor në të gjitha llojet e arsimit të mesëm të ulët. Shkollat e integrojnë të nxënësit për botën e punës në lëndë të tilla si Teknologji, Shkencat sociale dhe Ekonomi. Lënda e quajtur "Studime para-profesionale", fokusohet më shumë në të nxënësin rreth botës së punës dhe synon orientimin e nxënësve për të qenë funksionalë në tregun e punës.

Koha mesatare që i kushtohet edukimit për karrierë në 16 Lande të Gjermanisë në këtë nivel shkollimi, është 2 orë në javë.

Për nxënësit e dy viteve të fundit të arsimit të mesëm të ulët, zhvillimi i përvojave në punë, synon informimin bazë për të hyrë në botën e punës si dhe njëherësh orientimin për zgjedhjen e një profesioni.

Ndër veprimtaritë e tjera me zgjedhje që realizohen nga shkolla janë:

- kontakte me persona nga bota e punës, vizita në panairë, vizita në shkolla profesionale dhe vizita në kompani etj;
- shërbime të këshillimit personal për nxënësit në shkollë dhe jashtë saj nga konsulentë të Shërbimit Federal të Punësimit;
- krijimi i firmave ushtrimore nga vetë nxënësit për t’u njohur më mirë me botën e punës.

Në bashkëpunim me shkollën, Shërbimi Federal i Punësimit organizon ditët e informimit për prindërit, si dhe forumet e punësimit.

ITALIA

Orientimi për karrierë shihet si një fushë ndërkurrikulare. Ai ofrohet për herë të parë në fund të arsimit bazë.

Veprimtaritë këshilluese ofrohen në mënyra të ndryshme në varësi të shkollës. Këto veprimtari zakonisht bazohen në dëshirat, aftësitë dhe nevojat e nxënësve. Qëllimi i tyre është t’i pajisë nxënësit me informacionin bazë lidhur me botën dhe ofertat arsimore e të punës dhe të lehtësojë vendimmarrjen e tyre lidhur me integrimin e mëtejshëm në arsim dhe punë.

Numri i nevojshëm i orëve mësimore për këtë qëllim në vitin e fundit të arsimit të mesëm të ulët, ndryshon nga një shkollë në tjetrën, në varësi të projekteve që duhen përmbushur nga çdo shkollë në një vit shkollor.

Ndër veprimtaritë e tjera me zgjedhje që realizohen nga shkolla janë:

- kontaktet me persona nga bota e punës, vizita në kompani;
- shërbime të këshillimit për nxënësit në shkollë përmes Qendrave të Karrierës pranë shkollave (këshillimi mund të jetë personal apo në grup për nxënësit dhe prindërit);
- shërbime të këshillimit jashtë shkollës nga zyrat e punësimit në rajonet përkatëse.

KANADAJA (Ontario)

Orientimi profesional përfshihet në fushën e aftësive të zbatuara dhe planifikimit personal. Aftësitë e aplikuara realizohen përmes lëndëve të “Edukimi teknologjik”, “Ekonomi shtëpiake”, “Edukim biznesi”.

KOSOVA

Në draftin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës, në rubrikën mbi kompetencat kryesore, përfshihen kompetencat për jetë, punë dhe mjedis, nr.4.3.4. Jeta dhe puna është një nga gjashtë fushat e përcaktuara të kurrikulës së Kosovës që përshkon të gjithë periudhën e arsimit nga “Edukimi i Hershëm i Fëmijës” deri në arsimin e mesëm të lartë, duke përfshirë dhe arsimin profesional.

Ndër dimensionet dhe temat ndërkurrikulare që sugjerohet të mbahen parasysh në kornizën kombëtare të Kosovës janë: zhvillimi personal dhe aftësimi për jetë, ndërjegjësimi për karrierën, përgatitja për jetë dhe punë, edukimi për sipërmarrje.

Në klasat 0-5, në fushën “Jeta dhe puna” synohet shkathtësimi për jetë, punëdore dhe ekonomi familjare. Në klasat 6-të dhe 9-të, synohet këshillim dhe Orientim për karrierë si dhe Teknologji (duke përfshirë edhe TIK), punë dhe edukim për sipërmarrje.

Fusha “Jeta dhe Puna” zë 10 % të volumit të kurrikulës së Kosovës në të gjitha klasat e arsimit 9-vjeçar.

POLONIA

Edukimi për karrierë është pjesë e kurrikulës kombëtare, si një fushë ndërkurrikulare. Shkollat kanë detyrim ta integrojnë atë në kurrikulat shkollore në lëndë të veçanta, si Edukimi për qytetari apo Shkencat shoqërore.

Në AMU lënda e detyruar Edukim për qytetari përmban elemente të këshillimit për punë që konsistojnë në këto tri nënfusha: edukimi familjar, edukimi qytetar dhe edukimi për pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike të vendit.

Ndër veprimtaritë e tjera me zgjedhje që realizohen nga shkolla janë:

- kontakte me persona nga bota e punës (projekte pilot për të forcuar lidhjen e shkollimit me jetën e punës, në kuadrin e programeve evropiane të arsimit Leonardo Da Vinci apo Comenius).
- shërbime të këshillimit për nxënësit përmes Qendrave të Karrierës pranë shkollës. Këto qendra ofrojnë këshillim personal apo në grup për nxënësit dhe prindërit.

Shërbime të këshillimit jashtë shkollës, nga institucione të specializuara në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punës.

SLLOVENIA

Në mbështetje të Kurrikulës Kombëtare të vitit 1998, Orientimi për karrierë është integruar nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të, si një qasje ndërkurrikulare, në lëndë të ndryshme të tilla si: Gjeografi – “të eksplorosh se me çfarë merren meteorologët”, lëndë të Arteve –“të vizitosh artistë të vërtetë në punë” etj.

Në arsimin fillor mësuesit e integrojnë informacionin për botën e punës dhe për profesione të ndryshme në lëndët e tyre apo në aktivitete të tjera jashtëkurrikulare.

Në AMU këshillimi realizohet nga mësuesit gjatë orëve të mësimi si edhe nga psikologët jashtë orëve të mësimi.

Në klasën e 7-të dhe të 8-të, nxënësit njihen me bazën elektronike të ofertave arsimore të AML (programe, shkollat, kërkesat e hyrjes, kohëzgjatjet dhe alternativa të tjera shkollimi) dhe mësojnë përdorimin e saj.

Të gjithë nxënësit pajisen me një broshurë falas të titulluar “Udhëzues profesionale”.

Ndër veprimtaritë e tjera që realizohen nga shkollat janë:

- kontakte me persona nga bota e punës dhe vizita në kompani (moshat 13-15 vjeç).

- shërbime të këshillimit për nxënësit në shkollë (këshillim personal, social dhe profesional).
- shkolla në bashkëpunim me aktore të tjerë ekspertë të fushës në rajon, organizon “konferencë në grup”, në të cilën diskutohen “preferencat profesionale” të çdo nxënësi sipas këndvështrimit të çdo eksperti pjesëmarrës.
- shërbime të këshillimit jashtë shkollës, nga këshilluesit në Shërbimin Publik të Punësimit.

SHQIPËRIA

Objektiva të aftësimit për jetën dhe punën gjenden të integruara në arsimin bazë kryesisht në lëndët Teknologji, Arte dhe Edukim qytetar.

Në vitin shkollor 2010-2011, për herë të parë po realizohet moduli i “Edukimit për karrierën” me 17 orë, në klasën e 9-të.

PJESA E DYTË: “ANALIZA E KURRIKULËS AKTUALE 1-9-të”

Erka Koci, Evis Mastori, Mirela Andoni

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Kurrikula aktuale për klasat 1-9-të është produkt i punës për reformimin e arsimit bazë të filluar që në vitin 1994 dhe i reformës së arsimit bazë të kryer në vitet 2003-2007. Ndryshimi i strukturës së arsimit bazë, kalimi nga 8 vjet (4+4) në 9 vjet (5+4) bëri të domosdoshme edhe reformën e kurrikulës (2003-2007) të këtij niveli shkollimi e cila u

mbështet nga dy dokumente zyrtare:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar (1995);
- Strategjia Kombëtare për Arsimin (2004 – 2015)1.

Ndryshimet në kurrikulë synuan rritjen e cilësisë së arsimit bazë, përshtatjen e arsimit me zhvillimet shoqërore dhe ekonomike në vendin tonë, hapjen e mëtejshme të arsimit shqiptar ndaj zhvillimeve botërore, decentralizimin e kurrikulës, si dhe pasurimin e mësimdhënie-nxënies me strategji dhe modele të reja të të nxënës.

Plani mësimor dhe programet lëndore janë dy dokumentet kryesore kurrikulare kombëtare mbi bazën e të cilave funksionon kurrikula aktuale për klasat 1-9-të.

Një nga dokumentet kryesore duhej të ishte Korniza Kurrikulare, e cila ka mbetur e pamiruar duke mos u bërë pjesë e kurrikulës kombëtare të arsimit bazë. Aktualisht kurrikula 1-9-të funksionon pa dokumentin bazë rregullator dhe konceptual, i cili do të siguronte koherencën përgjatë gjithë sistemit.

Dokumenti tjetër kryesor duhej të ishin standardet e të nxënës. Për strukturën 1-9-të nuk janë hartuar standardet e nxënës. Standardet lëndore të miratuara për strukturën 1-8-të nuk u përditësuan për strukturën e re.

Kurrikula aktuale për klasat 1-9-të ka mundësuar zbatimin me tekste bazë alternative brenda sistemit të tregut të lirë.

Zbatimi i kurrikulës mbështetet me udhëzues kurrikularë të përgjithshëm dhe për grupime lëndore, të hartuar në nivel qendror, udhëzime të posaçme si dhe botime të ndryshme.

Për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës kombëtare për klasat 1-9-të, specialistët dhe mësuesit kanë konstatuar mangësi në: a) konceptimin e përgjithshëm të kurrikulës, b) planin mësimor dhe programet lëndore, dhe c) zbatimin e tyre në shkollë. Pavarësisht se procesi i reformimit ka patur uljet dhe ngritjet e veta, apo mund të shihen probleme dhe defekte, në tërësi mund të konsiderohet një platformë për zhvillimin në të ardhmen.

2. DOKUMENTET KRYESORE TË KURRIKULËS KOMBËTARE

PLANI MËSIMOR

Plani mësimor aktual i arsimit bazë për klasat 1-9-të u miratua nga MASH në qershor 2004. Në këtë plan përcaktohen lëndët dhe orët javore të tyre për secilën klasë.

Ky është i pari plan mësimor që i përgjigjet strukturës 5+4 të arsimit bazë mbi të cilin u zhvillua e gjithë kurrikula 1-9-të. (Shihni planin mësimor te kapitulli “Kurrikula bërthamë”)

Numri minimal i orëve javore është 20 në klasat (1-2). Numri maksimal i orëve javore është 29 në klasat (7-9).

Numri i lëndëve¹⁴

Klasa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Numri i lëndëve	8	8	10	11	11	13	15	14	13

Lëndë të integruara

Lëndë të integruara janë lënda Dituri natyre dhe Vendlindja, të cilat mësohen përkatësisht në klasat e 3-ta, 4-ta dhe të 5-ta.

Lëndë me zgjedhje

Në planin mësimor janë parashikuar (për herë të parë) 1 orë/javë ose 2 orë/javë për veprimtari jashtëkurrikulare dhe lëndë me zgjedhje. Në përgjithësi janë shkollat ato që vendosin për këto orë.

Numri i orëve javore për lëndë

Matematika dhe Gjuha amtare janë lëndët që zhvillohen me më shumë orë në javë, me diferenca të konsiderueshme me lëndët e tjera.

Shumica e lëndëve të tjera zhvillohen me 1-2 orë në javë. Në pesë klasat e para numri i lëndëve me 1 orë/javë është 5.

Për lëndën Dituri natyre, veprimtaritë jashtëkurrikulare dhe lëndët me zgjedhje, numri i orëve javore herë ulet dhe herë ngrihet.

Për veprimtaritë jashtëkurrikulare dhe lëndët me zgjedhje, numri i orëve javore pakësohet me 1 orë në klasat 7, 8 dhe 9-të.

Ecuria e lëndëve përgjatë viteve të shkollimit

¹⁴ Shtatë lëndë janë me program të detyruar dhe një lëndë është e lirë të konceptohet nga shkolla.

Shumica e lëndëve fillojnë në një klasë të caktuar dhe vazhdojnë deri në klasën e 9-të. Disa lëndë fillojnë në një klasë të caktuar dhe ndërpriten pas disa vitesh (p.sh. Aftësim teknologjik, Edukim figurativ).

PROBLEMET

- Mungon Korniza Kurrikulare që siguron koherencën horizontale dhe vertikale gjatë viteve.
- Plani mësimor aktual ka numër të madh lëndësh.
- Plani mësimor nuk përputhet me synimin e integritit të lëndëve të përshkruar në Strategjinë e Arsimit 2004-2015.
 - Vizioni që përçjell plani mësimor është tradicional sepse është i organizuar në lëndë dhe jo në fusha të nxëni gjë që pengon integrimin lëndor.
- Kurba e integritit ndërpritet dukshëm që në klasën e 6-të duke shtuar numrin e lëndëve në planin mësimor.
- Ka një numër të konsiderueshëm të lëndëve me 1 orë /javë, veçanërisht në pesë vitet e para.
- Ka lëndë për të cilat luhatja ose ndërprerja e orëve në vite nuk është e arsyeshme.
- Në shumicën e klasave, përfshirë edhe klasën e 8-të dhe të 9-të, lëndët me zgjedhje janë alternativë e barasvlershme me veprimtaritë jashtëkurrikulare.
- Koha e lënë në dispozicion për lëndët me zgjedhje pakësohet me 50% në klasat 7, 8 dhe 9-të krahasuar me klasat 4, 5 dhe 6-të.

PROGRAMET LËNDORE

Gjendja aktuale

Programet lëndore, të cilat zbatohen aktualisht në shkollat tona, janë hartuar dhe miratuar zyrtarisht nga MASH në periudhën 2003-2007. Një pjesë e vogël kanë pësuar ripunime të pjesshme gjatë viteve.

- Formatit i strukturës së programeve u rikonceptua me rubrika si: linjat dhe objektivat, metodologjia e zbatimit, zhvillimi i të menduarit kritik e krijues, lidhja me lëndët e tjera, vlerësimi.
- Përmbajtja në programe paraqitet për herë të parë jo me tema, por me linja dhe me objektiva, të cilat vënë theksin në rezultatet e të nxënit.
- Programet janë fleksibël në kuptimin që nga një program mund të hartohen tekste bazë të ndryshëm si dhe tekste e materiale të tjera ndihmëse me karakter zbatues.
- Programet përmbajnë elemente të zhvillimit të kurrikulës në bazë shkolle, nëpërmjet “orëve të lira”. Në çdo program rreth 15% e orëve totale janë lënë në dispozicion të mësuesit.
- Orët e lira mund të përdoren për përforcimin e lëndës, projekte kurrikulare të lëndës ose mes disa lëndëve, lëndë me zgjedhje, module mësimore, vlerësime të arritjeve në nivel shkolle.
- Në disa programe gjenden elemente të përfshirjes së TIK₇.
- Në disa lëndë ka një lidhje vertikale më të mirë krahasuar me lëndë të tjera.

Problemet

- Hartimi i programeve është kryer në mënyrë paralele: Klasa e 2-të dhe e 6-të, klasa e 3-të dhe e 7-të, klasa 4-t dhe e 8-të, klasa e 5-të dhe e 9-të, në përputhje me planin procedural të reformës arsimore. Kjo veçori ka bërë që programi i klasës së 6-të të hartohet pa u hartuar programi i klasës së 5-të dhe pa u bazuar në standardet lëndore.
- Nuk ka një konceptim unik të programeve lëndore si rrjedhojë e mungesës së kornizës kurrikulare.
- Struktura e programeve lëndore dhe rubrikat që e përbëjnë nuk janë gjithmonë uniforme dhe paraqiten me ndryshime nga lëndë në lëndë, nga klasa në klasë, nga viti në vit. Rubrikat nuk janë po ato, jo vetëm midis lëndëve të ndryshme, por shpesh edhe brenda së njëjtës lëndë nga viti në vit. Vihet re që programe të ndryshme lëndore përdorin terminologji të ndryshme, si p.sh., “Synime”, “Qëllime të përgjithshme” ose “Objektiva të përgjithshëm”. Disa rubrika të programeve lëndore, si “Metodologjia” dhe “Vlerësimi”, formulohen në terma të përgjithshëm dhe jo në terma praktike për përdorim.
- Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare nuk janë të integruara dhe prezente në të gjitha programet si rrjedhojë e mungesës së kornizës kurrikulare.
- Në të gjitha programet lëndore mund të gjenden shembuj të mungesës së lidhjes vertikale.
- Lidhja horizontale (mes lëndësh të ndryshme brenda të njëjtës klasë) është më pak e garantuar se lidhja vertikale brenda së njëjtës lëndë.
- Programet e bazuara në planin mësimor aktual janë të mbingarkuara dhe kjo rezulton kryesisht për shkak, se:
 - përqendrohen më tepër tek njohuritë se sa tek proceset dhe aftësitë e të nxënit;
 - kanë mbivendosje të njohurive brenda së njëjtës lëndë ashtu edhe në lëndë të ndryshme;
 - objektivat dhe përmbajtja e programeve jo gjithmonë përshtaten sa duhet me moshën dhe kapacitetet reale të nxënësve.
- Në programe pothuajse nuk ka elemente të të mësuarit të diferencuar.
- Ka përpjekje për përfshirjen e TIK në programe, por janë sporadike.

3. DOKUMENTET KRYESORE TË KURRIKULËS MBËSHTETËSE

UDHËZUESIT KURRIKULARË

Gjendja aktuale

Zbatimi i kurrikulës 1-9-të mbështetet me udhëzuesin e përgjithshëm dhe udhëzuesit për grupimet lëndore të kurrikulës në arsimin bazë. Udhëzuesit kurrikularë janë materiale sqarues dhe ndihmës për përdoruesit e kurrikulës në përgjithësi dhe për mësuesit në veçanti, për planifikimin dhe zbatimin e saj në përputhje me parimet e dokumenteve kryesore kurrikulare.

- Udhëzuesi i përgjithshëm ndihmon në kuptimin dhe zbatimin e parimeve e synimeve kryesore të kurrikulës 1-9-të. Në këtë udhëzues janë përfshirë edhe kompetencat europiane në arsimin bazë.
- Udhëzuesit lëndorë ndihmojnë në kuptimin dhe zbatimin e programeve për secilën lëndë.

Problemet

- Materialet që ofrojnë udhëzuesit kurrikularë janë disi teorikë e të përgjithshëm dhe nuk ndihmojnë sa duhet mësuesin.
- Udhëzuesit kurrikularë nuk i janë nënshtruar përmirësimeve të vazhdueshme në përmbushje të nevojave konkrete të mësuesve dhe përdoruesve të tjerë të kurrikulës.
- Përdorimi i udhëzuesve kurrikularë nuk u shoqërua mjaftueshëm me trajnimin e nevojshëm të të gjithë mësuesve të arsimit 9-vjeçar, ashtu sikurse dhe sasia e botuar ishte jo e mjaftueshme për të gjithë mësuesit përdorues.

TEKSTET SHKOLLORE

Gjendja Aktuale

Si rrjedhim i reformës së Altertekstit, mësuesit e zgjedhin tekstin shkollor me të cilin ata do të punojnë në shkollë. Në këtë mënyrë, në shkollën shqiptare përdoren tekste të ndryshme në shkolla të ndryshme.

Problemet

- Nga nxënësit dhe mësuesit shumica e teksteve konsiderohen si të vështirë dhe të ngarkuar me një numër të madh konceptesh. Kjo rezulton për shkak, se:
 - në disa raste tekstet tejkalojnë objektivat e programit duke shtuar mbingarkesën;
 - në një pjesë të teksteve, trajtimet konceptuale, gjuha dhe terminologjia e përdorur janë të vështira për moshën e nxënësve.
- Një pjesë e mësuesve nuk i referohet programit, por vetëm tekstit dhe në rastin e teksteve të vështira kjo gjë shton mbingarkesën.
- Në disa raste teksteve u mungon hapësira e nevojshme për të zhvilluar aftësi të të menduarit kritik e krijues, aftësi të punës në grup, punës me projekte etj.

KURRIKULA E ZBATUAR

Për të përcaktuar gjendjen e kurrikulës së arsimit 9-vjeçar, tregues i rëndësishëm në garantimin e cilësisë së saj është edhe kurrikula e zbatuar.

Mësuesi është një nga aktorët kryesorë në garantimin e cilësisë së produktit kurrikular.

Problemet

- Për arsye të mbingarkesës të disa programeve dhe teksteve, mësuesit nuk kanë kohë reale për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik, të menduarit krijues, menaxhimit të informacionit, të punuarit në grup apo për të punuar në mënyrë të diferencuar me nxënës me nevoja të veçanta.
- Mësuesit nuk kanë marrë mjaftueshëm trajnime të posaçme për të kuptuar pritshmëritë dhe ndryshimet në kurrikulë.
- Disa nga mangësitë e kurrikulës së zbatuar vijnë dhe si rrjedhojë e mungesës së një debati të gjerë e sistematik në lidhje me vizionin e ri kurrikular që nga fillimi i reformës me një pjesë të madhe të mësuesve.
- Ka raste të mungesës së laboratorëve që do të mundësonin një realizim më cilësor të procesit të mësimdhënies e nxënies.

PJESA E TRETË: “RISHIKIMI I KURRIKULËS SË ARSIMIT BAZË”

Marita Hamza, Yllka Spahiu

I. NEVOJA PËR RISHIKIM

Kurrikulat ekzistuese për klasat 1-9-të reflektojnë disa elemente të modeleve të sotme kurrikulare, por ato nuk janë funksionale dhe të përgjithësuara. Specialistët dhe mësuesit evidentojnë një sërë defektesh në formatin e përgjithshëm të kurrikulës, në planin mësimor, në programin mësimor si dhe në zbatimin e tyre në nivel shkolle.

Nga ana tjetër, kurrikula arsimit bazë duhet të sigurojë koherencën me kurrikulën tashmë të reformuar të gjimnazit.

II. PËRMIRËSIME KRYESORE TË KURRIKULËS SË ARSIMIT BAZË

1. NDRYSHIMI I STRUTURËS SË ARSIMIT BAZË

Projektligji i sistemit arsimor parauniversitar parashikon shtimin me një vit të arsimit fillor (primary education) duke e kthyer strukturën e arsimit bazë nga 5+4 në 6+3.

Në rreth 2/3 e vendeve të OECD arsimit bazë funksionon sipas strukturës 6+3.

Studiuesit dallojnë dy faza të zhvillimit mendor të fëmijëve: deri në moshën 12 vjeç dhe pas saj. Gjatë periudhës 6-12 vjeç mbizotëron kryesisht dhe përgjithësisht të menduarit konkret, kurse më pas ai abstrakt. Ky dallim përcakton si përmbajtjen e lëndëve, ashtu dhe metodat e mësimdhënie-nxënies në secilën prej dy fazave. Me strukturën aktuale, ku cikli fillor zgjat pesë vjet, nisin më herët nga sa duhet shprehitë e të menduarit abstrakt dhe më shpejt nga sa nxënësit në përgjithësi mundën.

Kalimi nga sistemi 5+4 në 6+3 mundëson standarde të arritjeve të nxënësve të krahasueshme me shumicën e sistemeve të tjera arsimore evropiane.

2. NDËRTIMI I KURRIKULËS MBI BAZËN E KOMPETENCAVE THEMELORE TË BE-së

Baza filozofike e formuluar nga BE për arsimin bazë do të jetë pikënisje dhe pikëmbërritje e kurrikulës sonë të re të AB. Kurrikula jonë, në ngjashmëri me kurrikulat e vendeve të BE-së, duhet të mundësojë që nxënësit të zotërojnë 8 kompetencat themelore të BE-së për të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe për zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialit të çdo individi në jetën aktive si qytetar dhe gjatë punësimit.

Kompetencat janë:

- Komunikimi në Gjuhën amtare;
- Komunikimi në Gjuhë të huaj;

- Kompetencat në Matematikë, në Shkencat natyrore dhe në Teknologji;
- Kompetenca digjitale;
- Kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Kompetencat ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare;
- Sipërmarrja, aftësia për të shndërruar idetë në veprime;
- Demonstrimi kulturor, d.m.th. mirëkuptimi i larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme.

3. INTEGRIMI KURRIKULAR

Integrimi kurrikular mundëson uljen e ngarkesës mësimore dhe zhvillimin e të menduarit holistik.

Kurrikula aktuale e arsimit bazë ka shumë lëndë dhe ngarkesë mësimore për nxënësit. Pakësimi i lëndëve mësimore sidomos në ciklin fillor, është një nga përmirësimet e nevojshme.

Ky pakësim nuk do të jetë thjesht mekanik por si rrjedhojë e theksimit të **integritit lëndor**.

Në këtë kurrikulë ekzistojnë vetëm dy shembuj të integritit lëndor: lënda e diturisë së natyrës dhe ajo e vendlindjes në të cilat gërshetohen njohuri nga Fizika, Kimia, Biologjia, Gjeografia, Gjeologjia etj. Kjo përvojë duhet zgjeruar më tej.

Përmasa të tjera integruese janë gjithashtu të domosdoshme të jenë pjesë e kurrikulës së re. Ato kanë të bëjnë me strukturimin e kurrikulës sipas fushave të të nxënës, vendosjen e aftësive kyç dhe temave kroskurrikulare në bazë të gjithë kurrikulës.

Kurrikula e tanishme nuk është e përvijuar sipas fushave të të nxënës. **Një kalim nga kurrikula në bazë lënde në atë me bazë fushat e të nxënës** do të mundësojë që të mësuarit të evidentojë dhe unifikojë të përbashkëtat duke evituar copëzimin dhe mungesën e lidhjes ndërmjet përmbajtjeve të lëndëve. Kështu normalizohet mbingarkesa e të nxënës.

Strukturimi i kurrikulës sipas aftësive ndërkurrikulare

Janë disa aftësi të pranishme në çdo lëndë apo fushë të nxënës, të cilat kanë rëndësi të veçantë për formimin e nxënësve në kurrikulat moderne. Aftësi të tilla ndërkurrikulare janë: të menduarit kritik, të menduarit krijues, menaxhimi i informacionit nga burime të larmishme, përdorimi i TIK-ut, puna në grupe etj.

Në kurrikulën ekzistuese, veçanërisht në disa programe lëndore dhe në udhëzuesit për mësuesit, shkruhet për këto aftësi, por në fakt ato nuk janë shndërruar në të vërtetë në lajtmotive të kurrikulës së shkruar dhe asaj të zbatuar në shkollë.

Përmendim në veçanti, aftësinë e përdorimit të TIK-ut në të gjitha lëndët që tashmë mbështetet në shkollat tona nga kompjuterët, laptop+projektor digjital dhe rrjeti i internetit.

Këto aftësi, do të jenë pjesë e rëndësishme në kurrikulën e përmirësuar të arsimit bazë.

Temat ndërkurrikulare

Kurrikulat moderne përshkohen tej për tej, nga disa tema (probleme) të jetës së përditshme, si p.sh. tema e edukimit mjedisor, edukimit për paqen, tema e shëndetit etj. Këto tema të rëndësishme në formimin e nxënësve nuk mund të përfshihen në një lëndë të vetme për shkak të natyrës dhe dimensioneve të gjera që kanë, ndaj trajtimi i tyre mundësohet me pjesëmarrjen e shumë kurrikulave lëndore.

Kurrikula aktuale e arsimit bazë nuk i ka të organizuara qartë dhe as vendos rezultatet e pritshme të nxënies për këto tema përshkuese. Një nga përmirësimet që do t'i bëhen kurrikulës së re është dhe identifikimi i temave të tilla dhe përfshirja e tyre në të gjitha fushat e të nxënies dhe lëndët.

4. KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Në kurrikulën aktuale është hedhur një hap nga larmia e ofertave kurrikulare sipas interesave të nxënësve. Në planin mësimor është parashikuar një numër i vogël orësh posaçërisht për zgjedhjet e nxënësve, që janë përdorur kryesisht për një Gjuhë të huaj të dytë.

Gjithashtu nëpërmjet të ashtuquajturave “orë të lira” rreth 10% e orëve mësimore përdoren nga mësuesi për projekte kurrikulare, të cilët janë edhe ndër lëndore dhe që në rastet më të mira temat e tyre përzgjidhen në bashkëpunim me nxënësit.

Kaq është pak po të vështrojmë përvojat e vendeve të tjera.

Zgjerimi i hapësirës për kurrikulën me zgjedhje nga nxënësit përmirëson zgjedhjen në kurrikulën e re.

Kjo zgjedhje përfshin:

- zgjedhje sipas interesave të nxënësve e që përfshijnë lëndë ose module të reja ose thellim të lëndëve ekzistuese;
- zgjedhje sipas nevojave të nxënësve, p.sh. zgjedhje e lëndëve për përforsim për nxënës që kanë vështirësi relative në të nxënies e një lënde të caktuar.

Përqindja që do të zërë kurrikula me zgjedhje është objekt i një studimi të thelluar krahasues dhe i përshtatjes së përvojave të huaja në kontekstin tonë.

5. MBINGARKESA

Përvojat e mësuesve, të nxënësve e të prindërve dëshmojnë për mbingarkesë në kurrikulën e arsimit bazë, gjë që ka sjellë pakësimin e interesit të nxënësve dhe lënien pas dore nga mësuesit të një pjese jo të vogël të tyre.

Lehtësimi i ngarkesës së nxënësve në të dyja përmasat, si në volumin e njohurive dhe në vështirësinë, bazuar në një studim shkencor mbi ngarkesën optimale të nxënësve sipas veçorive të zhvillimit moshor, do të jetë në fokus të rishikimit të kurrikulës së arsimit bazë.

III. PRITSHMËRI PËR KURRIKULËN E RE TË AB

Kurrikula e re në arsimin bazë, mbështet filozofinë e të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe merr në konsideratë kontekstin kombëtar dhe kontekstin rajonal dhe evropian.

Ajo do të jetë:

- Kurrikulë me nxënës në qendër, që plotëson nevojat dhe interesat e tij dhe të shoqërisë për tani dhe për të ardhmen.
- Kurrikulë me ngarkesë të normalizuar.
- Kurrikulë me thekse integrale.
- Kurrikulë që nxit mendimin kritik e krijues dhe aftësi të tjera bazë.
- Kurrikulë që siguron jo vetëm njohuri lëndore por dhe aftësi sociale, aftësi për jetën, vlera qytetare.
- Kurrikulë që siguron impakte të thella të TIK-ut (si lëndë me vete, si mjet mësimor i zbatuar në të gjitha lëndët).
- Kurrikulë e bazuar në rezultatet e të nxënësve dhe vlerësimin e tyre.

IV. PREMISA PËR SUKSESIN E KURRIKULËS SË RISHIKUAR

Rishikimi i kurrikulës së arsimit bazë është sfidë në aspektin profesional dhe menaxhues.

1. EKSPERTIZA E MJAFTUESHME PËR KURRIKULËN E SHKRUAR

Në Shqipëri ekziston ekspertiza e mjaftueshme profesionale për të realizuar plotësisht ambicien e përmirësimit të ndjeshëm të kurrikulës së arsimit bazë.

Specialistë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e të institucioneve të varësisë qendrore e të IZHA-së si dhe shumë mësues të AB kanë përgatitjen e mjaftueshme profesionale, falë një periudhe tanimë afatgjatë të përvetësimit të koncepteve e praktikave moderne në fushën e kurrikulës moderne.

Grupi Qendror i Rishikimit të Kurrikulës së Arsimit Bazë pranë MASH, një strukturë e ngritur për herë të parë, krijon garancinë e cilësisë falë vështrimit më të gjerë të procesit dhe të produkteve të ndërmjetme e përfundimtare.

2. AUTORËT E TEKSTEVE

Pavarësisht nga krijimi i mundësive për mësuesit dhe nxënësit për shfrytëzimin e burimeve alternative të informacionit, teksti i nxënësve mbetet akoma si burimi kryesor i mësimdhënies dhe nxënies.

Përvoja dëshmon se edhe në rastet e programeve lëndore të arrira, një rënie e ndjeshme në arritjet e nxënësve vjen nga disa tekste të mbingarkuar, në të cilët filozofia bazë e kurrikulës ndjehet dobët. Ndërsa kurrikula e rishikuar do të jetë një e tërë nga pikëpamja e kompetencave themelore, të aftësive ndërkurrikulare e të parimeve themelore të mësimdhënies e të vlerësimit të nxënësve, tek tekstet nuk gjendet niveli i dëshiruar i homogjenitetit.

Bashkëpunimi me autorët e teksteve është një sfidë menaxheriale e domosdoshme për të pasur sukses e për të krijuar shkollën shqiptare të autorëve të teksteve.

3. MËSUESIT

Me gjithë ndryshimet e mira në profesionalizimin e mësuesve gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, ende mësuesi tipik nuk arrin të realizojë filozofinë dhe praktikën e një kurrikule moderne. Meqë suksesi i mësuesit është suksesi i sistemit arsimor, rishikimi i kurrikulës do të bashkërendohet me një trajnim paraprak dhe në vazhdim të mësuesve për të përballuar konceptin e kurrikulës tërësore dhe të parimeve bashkëkohore të mësimdhënies.

Reforma e sistemit të trajnimit të mësuesve me parimin e krediteve dhe të tregut të agjencive trajnuese është bazë për zhvillimin profesional efektiv dhe më të shpejtë të mësuesve.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

Tabela 1: Struktura e sistemit të arsimit bazë

Tabela 2: Organizimi i kohës mësimore në arsimin bazë

Tabela 3: Numri i orëve mësimore vjetore për klasë në arsimin bazë


Tabela 4: Të dhëna të modeleve kurrikulare

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19

Nr	Shteti	Arsimi Fillor (AF)			Arsimi i Mesëm i Ulët (AMU)			AB
		AF (ISCED 1)			AMU (ISCED 2)			
		Mosha (vjeç)	Nivelet e arsimimit (klasa)	Kohëzgjatja AF (vite)	Mosha (vjeç)	Nivelet e arsimimit (klasa)	Kohëzgjatja AMU (vite)	
1	Angli	5 – 11	1 – 6	6	11 – 14 + 2 vite AML 16 vjeç	7 – 9	3	9
2	Finlandë	7 – 13	1 – 6	6	13 – 16	7 – 9	3	9

3	Francë	6 – 11	1 – 5	5	11 – 16	6 – 10	4	9
4	Greqi	6 – 12	1 – 6	6	12 – 15	7 – 9	3	10
5	Gjermani	6 – 10	1 – 4	4	10 – 16	5 – 10	6	10
6	Irlandë	6 – 12	1 – 6	6	12 – 15 + 1 vite AML 16 vjeç	7 – 9	3	9
7	Itali	6 – 12	1 – 5	5	11 – 16	6 – 10	5	8
8	Kanada	6 – 12	1 – 6	6	12 -15	7 – 9	3	8/9
9	Kore	6 - 12	1-6	6	12 -15	7-9	3	9
10	Kosovë	6 – 11	1 – 5	5	11 – 15 + 2 vite AML 17 vjeç	6 – 9	4	9
11	Poloni	7 – 13	1 – 6	6	13 – 16	7 – 9	3	9
12	Slloveni	6 – 12	1 – 6	6	12 – 15	7 – 9	3	9
13	SHBA	6 – 10	1 – 4	4	11 - 14	5 – 8	4	8
14	Shqipëri	6 – 11	1 – 5	5	11 – 15	6 – 9	4	9

Tabela 2. Organizimi i kohës mësimore në arsimin bazë



Nr	Shteti	Ditë në vit	Ditë në javë	Minuta në orë	Orë në vit	Orë në javë
1	Angli	190	5	E ndryshme, vendos shkolla	798 - 893	21 – 23.5
					912 - 950	24 - 25
2	Finlandë	190	5	60	722 - 912	19 - 24
					1140	30
3	Francë	180	5	50	864	24
					910 – 1108	26-30
4	Gjermani (Bavari)	180	5	45	564 -733	20 - 27
					846 – 959	30-32

5	Irlandë	176 -183	5	30 - 40	915	28
					957	-
6	Itali	200	5	60	891	24-27
					1089	29-30
8	Kore	150-170	5	40 - 45	740 – 952	25 - 32
					1156	28-34
9	Kosovë	185	5	45	836	20 -25
					1044	27-31
10	Poloni	180	5 - 6	45	874 - 1064	23 – 28
					1178	31
11	Slloveni	175 -190	5	45	626-797	20
					839 - 897	27.5
12	SHBA	180	5	E ndryshueshme	E ndryshueshme	E ndryshueshme
					E ndryshueshme	E ndryshueshme

13	Shqipëri	175	5	45	700-805	21-29
					945 -1015	29 -30
	Mes.	182	5	48	820	24
					996	29
	Min.	170	5	30	648	20
					868	24.5
	Max.	200	6	60	969	28.5
					1140	34

Tabela 3. Numri i orëve mësimore vjetore për klasë në arsimin bazë

Klasa	Angli	Irlandë	Francë	Itali	Sloveni	Greqi	Kore	Poloni	Finlandë	Gjermani	Kosovë	Shqipëri	Mes	Max	Min
1	798	641	864	792	626	578	830	1856	569	564	4181	700	697	864	564
2	798	641	864	891	655	578	850		569	592		700	714	891	569
3	893	824	864	891	683	709	986		640	705		805	791	893	640

4	893	824	864	891	740	709	986	2453	640	733		805	800	893	640	
5	893	824	864	891	797	788	1088		676	846		805	847	893	676	
6	893	824	910	990	797	788	1088		630	959	3219	945	883	990	630	
7	912	824	839	990	897	788	1156	2728	868	959			980	805	990	788
8	912	824	947	990	911	788	1156		868	931			929	926	990	788
9	912	824	1036	825	839	788	1156		867	902	960	1015	917	1036	788	
10	950	824	1108	891			1224			846			957	1108	824	
11	950													-	-	
Totali (AB)	7904	7050	8052	8151	6945	6514	9296	7037	6327	7191	8832	7945	7596	9296	6327	

SHTOJCA 2

Përshkrimi i aftësive kryesore ndërkurrikulare

Tabela 5: Fushat e të nxënit (AF)

Tabela 6: Fushat e të nxënit (AF)

Tabela 3: Fushat e të nxënit (AMU)

Tabela 4: Fushat e të nxënit (AMU)

PËRSHKRIMI I AFTËSIVE NDËRKURRIKULARE

Aftësitë ndërkurrikulare konsiderohen shumë të nevojshme për arritjen e suksesit në jetën e përditshme dhe në punë. Ato zhvillohen tek nxënësit përmes të gjitha fushave të të nxënit, përgjatë arsimit bazë dhe në arsimimin e mëtejshëm. Aftësitë ndërkurrikulare, temat ndërkurrikulare, si edhe fushat e të nxënit, përbëjnë drejtimet kryesore të integritit të kurrikulës.

Aftësitë ndërkurrikulare është e vështirë të shihen të ndara nga njëra-tjetra, pasi zhvillimi i njërës ka lidhje me të tjerat. Përcaktimi i këtyre aftësive në kurrikulë mbështetet në disa kritere:

- Të jenë të vlefshme *për të gjithë* nxënësit;
- T'i shërbejnë zhvillimit të vlerave të shoqërisë;
- T'i përshtaten kontekstit dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria.

Më poshtë përshkruhen aftësitë ndërkurrikulare të evidentuara më shpesh përgjatë analizës dhe treguesit përkatës për secilën prej tyre¹⁵.

¹⁵ Përshkrimi bazohet në kurrikulat e shteteve të marra në studim, në Kornizën e Re Kurrikulare dhe në Udhëzuesin Kurrikular të gjimnazit të vendit tonë.

Aftësia e komunikimit

Aftësia e komunikimit lidhet me përdorimin e duhur të aftësive të gjuhës së folur dhe të shkruar në kontekste të ndryshme.

Zhvillimi i aftësisë së komunikimit i bën nxënësit të aftë:

- të komunikojnë nëpërmjet të shkruarit dhe të shprehurit me gojë mesazhe të ndryshme, në situata të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
- të monitorojnë nëse mesazhi po merret drejt;
- të iniciojnë, të mbështesin dhe të përfundojnë një bashkëbisedim në kontekste të ndryshme komunikimi;
- të lexojnë dhe kuptojnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme duke përdorur strategjitë e duhura për qëllime të ndryshme të të lexuarit;
- të shkruajnë tekste për qëllime të ndryshme;
- të formulojnë argumente në gjuhën e folur ose të shkruar, duke marrë në konsideratë këndvështrimet e të tjerëve.

Aftësia e përdorimit të Matematikës

Aftësia e përdorimit të Matematikës përfshin përdorimin e veprimeve, arsyetimin dhe metodikën matematikore për zgjidhjen e problemeve në kontekste të ndryshme. Zhvillimi i aftësisë së përdorimit të Matematikës i bën nxënësit të aftë:

- të kuptojnë dhe të përdorin gjuhën matematikore të lidhur me numrat dhe përlloraritjet, me synim përpunimin e të dhënave, zgjidhjen e problemeve komplekse dhe shpjegimin e arsytimeve të bëra;
- të zbatojnë njohuri dhe aftësi matematike në fusha të tjera të të nxënësit dhe në situata të jetës së përditshme.

Aftësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK)

Zhvillimi i aftësisë së përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) i bën nxënësit të aftë:

- të përdorin TIK-un për të kërkuar dhe menaxhuar informacione të nevojshme;
- të bëjnë parashikime dhe të zgjidhin situata problemore me ndihmën e TIK-ut;
- të paraqesin punën individuale ose të grupit duke përdorur TIK-un;
- të bashkëpunojnë me të tjerët nëpërmjet komunikimit elektronik.

Aftësia e menaxhimit të informacionit

Aftësia e menaxhimit të informacionit përfshin aftësinë për të përzgjedhur, përpunuar dhe përdorur informacionin në mënyrë efektive në kontekste të ndryshme.

Zhvillimi i aftësisë së menaxhimit të informacionit i bën nxënësit të aftë:

- të përzgjedhin burimet e ndryshme të informacionit dhe të sigurojnë informacion në përshtatje me qëllimin;
- të përdorin strategji të ndryshme për analizën, përpunimin dhe interpretimin e informacionit;
- të përzgjedhin, të organizojnë, të përpunojnë dhe të komunikojnë informacionin.
- të paraqesin informacionin duke përdorur një larmi teknologjish informacioni dhe komunikimi.

Aftësia e të menduarit kritik

Të mendosh në mënyrë kritike do të thotë të jesh mendjehapur, i pavarur në gjykime, argumentues dhe të japësh përgjigje ose të marrësh vendime pas një shqyrtimi të imët, të gjithanshëm dhe të thellë të rrethanave.

Zhvillimi i aftësisë së të menduarit kritik i bën nxënësit të aftë:

- të sjellin argumente dhe dëshmi për të mbështetur përfundimet, përgjithësimet dhe bindjet individuale;
- të mbajnë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj informacionit si edhe ndaj gjykimit dhe qëndrimeve të tjerëve;
- të dallojnë faktet nga interpretimet e tyre;
- të shqyrtojnë mundësi të ndryshme pro dhe kundër për një çështje të caktuar.

Aftësia e të menduarit krijues

Nxënësit mendojnë në mënyrë krijuese përmes gjenerimit dhe eksplorimit të ideve, krijimit të lidhjeve origjinale mes tyre dhe gjetjen e një larmie zgjidhjesh për situatat problemore.

Zhvillimi i aftësisë së të menduarit krijues i bën nxënësit të aftë:

- të shprehin përmes një larmie formash anët origjinale të personalitetit të tyre në shkollë, komunitet dhe punë;
- të pranojnë dhe kërkojnë ide dhe rrugëzgjdhje të reja;
- të gjenerojnë ide dhe të eksplorojnë mundësitë për realizimin e tyre;
- të përshtatin idetë në varësi të rrethanave;
- të përdorin imagjinatën.

Aftësia e zgjidhjes së situatave problemore

Kjo aftësi u jep nxënësve mundësinë të zgjidhin e të menaxhojnë situatat e larmishme problemore të jetës së përditshme. Kjo do të thotë të përdorësh njohuritë e fituara për të zgjidhur një problem në një situatë të panjohur më parë.

Zhvillimi i aftësisë së zgjidhjes së situatave problemore i bën nxënësit të aftë:

- të identifikojnë dhe të kuptojnë një problem si dhe të gjejnë rrugët për zgjidhjen e tij;
- të gjejnë zgjidhje të ndryshme dhe t'i vlerësojnë ato në përputhje me dobinë dhe zbatueshmërinë;
- të monitorojnë dhe të vlerësojnë ecurinë e etapave të zgjidhjes së situatave problemore me qëllim përmirësimin e tyre.

Aftësia e të punuarit në grup

Aftësia e të punuarit në grup u mundëson nxënësve të punojnë me të tjerët, të ndajnë dhe të marrin përgjegjësi, në përmbushjen e detyrave të ndryshme. Ata dëgjojnë dhe marrin në konsideratë mendimet e të tjerëve duke krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me ta.

Zhvillimi i aftësisë së të punuarit në grup i bën nxënësit të aftë:

- të bashkëpunojnë me të tjerët për arritjen e qëllimeve të përbashkëta;
- të arrijnë marrëveshje, të menaxhojnë diskutime për arritjen e rezultateve;
- të përshtatin sjelljen e tyre ndaj roleve dhe situatave të ndryshme përfshirë rolet drejtuese;

- të marrin përgjegjësi individuale duke u mbështetur në mundësitë dhe aftësitë që zotërojnë.

Aftësi qytetare

Nxënësit angazhohen aktivisht për çështje që ndikojnë në jetën e tyre dhe të të tjerëve.

Ata luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e shkollës, në komunitet dhe më gjerë.

Zhvillimi i aftësisë qytetare i bën nxënësit të aftë:

- të vlerësojnë sjelljet, veprimet dhe qëndrimet e tyre dhe të tjerëve në dobi të të mirës së përbashkët të komunitetit e më gjerë;
- të jenë pjesëmarrës aktivë të veprimtarive të cilat, synojnë përmirësime në nivel komuniteti, rajoni dhe më gjerë;
- të jenë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- të diskutojnë për çështje që i shqetësojnë duke kërkuar zgjidhje.

TABELA KRAHASUESE E FUSHAVE TË TË NXËNIT NË ARSIMIN BAZË

Katër tabelat e mëposhtme paraqesin një analizë krahasuese të modeleve, në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët bazuar në këta tregues :

- Llojet e fushave të të nxënës.
- Përqindjet për secilën fushë të të nxënës apo lëndë në varësi të modeleve kurrikulare të marra në analizë.

Në burimet që jemi referuar mungon informacioni për shpërndarjen e orëve mësimore ndërmjet fushave dhe lëndëve në këto shtete: Angli, SHBA, Kanada dhe Itali (AF), ndaj dhe në tabelat të shtojcat nuk do të gjeni raportet në përqindje ndërmjet fushave për këto shtete.

Kurrikula e Anglisë, SHBA-së, Kanadasë dhe Italisë është fleksibël. Shkolla vendos vetë për shpërndarjen e orëve mësimore ndërmjet fushave të të nxënës dhe lëndëve.

Legjenda e tabelës: ■ Arsimi fillor AF (ISCED 1)
■ Arsimi i mesëm i ulët AMU (ISCED 2)

TABELA 1 – AF													
Fusha të të nxëniet ose lëndë dhe raportit mes tyre në AF													
Anglia		Finlanda		Franca		Greqi		Gjermani		Irlanda		Itali	
Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %	Fushat e të nxëniet/lëndët	AF %
Gjuhë angleze	-	Gjuhë amtare letërsi	18	Gjuhë frënge	38	Gjuhë greke	22	Gjuhë gjermane	22	Gjuhë	34	Gjuhët dhe komunikimi	-
Matematikë	-	Matematikë	14	Matematikë	21	Matematikë	11	Matematikë	18	Matematikë	14	Matematikë	-
Shkenca	-	Studime natyrore dhe mjedisore	18	Zbulim i botës (kl.1-2)	9	Histori	4	Studime të përgjithshme	-	Edukim shoqëror, mjedisor dhe shkencor	14	Shkenca natyrore	-
Histori	-	Arte dhe edukim fizik	25	Histori-Gjeografi-Ed.qytetar (kl.3-5)	9	Studime mjedisore	6	-	-	Edukim shoqëror, personal dhe shëndetësor (qytetari)	2	Shkencat shoqërore	-
Gjeografi	-	Gjuhë huaj	9	Edukim fizik dhe sporte	12.5	Gjeografi	2	Edukim fizik	20	Edukim fizik	4	Gjuhë e huaj e parë	-
Teknologji dhe dizejnim	-	Gjuhë me zgjedhje	2	Praktikë arti dhe histori arti (kl.1-2)	9	Shkencat natyrore	3	Arte	11	Edukim artistik	14	Edukim fizik	-
TIK	-	Ekonomi shtëpiake	1	Kulturë humane (kl.3-6)	6.5	Qytetari dhe studime shoqërore	1	Gjuhë e huaj e parë	7	Edukim fetar	9	Edukim artistik	-
Art dhe dizejnim		Feja dhe etika	4	Shkenca eksperimentale dhe teknologji (kl.3-5)	9	Edukim artistik	8	-	-			Feja dhe etika	7.6
Muzikë		Këshillim	1	Gjuhë e huaj		Edukim fizik	5	Teknologji	-			Teknologji	-
Edukim fizik						Sporte	7	Feja	18				
Edukim fetar						Gjuhë e huaj 1 – Anglisht	9						
						Zona fleksibël e veprimt. Ndërdisciplinore dhe krijuese	8						
						Gjuhë e huaj e 2-të	2						
						Edukim fetar	4						

TABELA 2 – AF
Fusha të të nxënit ose lëndët dhe raportit mes tyre në AF

Kanada		Kore			Kosovë		Poloni			SHBA		Slloveni			Shqipëri		
Fushat e të nxënit/lëndët	AF %	Fushat e të nxënit/lëndët	AF %			Fushat e të nxënit/lëndët	AF %	Fushat e të nxënit/lëndët	AF %		Fushat e të nxënit/lëndët	AF %	Fushat e të nxënit/lëndët	AF %		Fushat e të nxënit/lëndët	AF %
			1-2	3-4	5-6				1-3	4-6				1-3	4-6		
Arte të gjuhës	-	Gjuhë koreane	26	22	18	Komunikimi dhe shprehurit të	25	Mësimdhënie e integruar (1-3)	75	-	Arte të gjuhës angleze	-	Gjuhë sllovene	31.7	20	Gjuhët dhe komunikimi	30.7
Arte	-	Edukim moral	4	3	3	Matematikë	20	Edukim fetar/Etikë	8.3	-	Matematikë	-	Matematikë	20.6	17.4	Matematikë	18.5
Frëngjisht	-	Shkenca shoqërore	7	10	9	Shkencat	10	Gjuhë polake		18	Studime shoqërore	-	Gjuhë e huaj	-	12	Shkenca natyrore	5.5
Matematikë	-	Matematika	15	13	12	Shoqëria dhe mjedisi	10	Histori dhe qytetari		4.5	Shkenca	-	Arte pamor	9.52	6.7	Shkencat shoqërore	8.4
Edukim fizik dhe shëndetësor	-	Shkenca	11	10	9	Shëndeti dhe mirëqenia	15	Gjuhë e huaj moderne		9	Shëndeti	-	Muzikë	9.52	5.3	Edukim fizik	9.3
Shkencë dhe teknologji	-	Arte praktike		-	6	Jeta dhe puna	10	Matematikë		13.7	Arte	-	Shkenca sociale	-	6.7	Edukim artistik	9.3
Studime sociale	-	Edukim fizik		10	9			Shkenca natyrore		10	Muzikë	-	Gjeografi	-	1.3	Gjuhë e huaj e parë	-
Kanadaja dhe bota	-	Muzikë	22	6	6			Muzikë		2	Edukimi fizik	-	Histori	-	1.3	Gjuhë të tjera	
		Arte të bukura		6	6			Art		2			Shkenca Natyrore	-	2.6	Teknologji	4.6
		Gjuhë të huaja - anglisht		3	6			Teknologji		2			Shkenca natyrore dhe Metoda		8		
		Veprimtari opsionale	7	6	6			Shkenca kompjuterike		2			Metoda dhe Teknologji		2.6		
								Edukim fizik		13.7			Ekonomi shtëpiake		3.3		
								Edukimi fetar/etik		6.6					12		

TABELA 3 AMU

Fusha të të nxënit ose lëndët dhe raporti mes tyre në AMU

Angli		Finlandë		Francë		Greqi		Gjermani		Irlandë		Itali	
Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %
Gjuhë angleze	-	Gjuhë amtare letërsi	12	Gjuhë frënge	17	Gjuha greke e vjetër dhe letërsia	14	Gjuha gjermane	13	Gjuhë dhe letërsi	30	Gjuhët dhe komunikimi	26.8
Matematikë	-	Matematikë	12	Matematikë	16	Gjuha greke moderne dhe letërsia	12	Matematikë	11	Matematikë	10	Matematikë	19
Shkenca	-	Studime natyrore dhe mjedisore	18	Shkenca dhe teknika (kl.7-8)	6	Matematikë	11	Shkenca natyrore	16	Shkencë dhe teknologji	12.5	Shkenca natyrore	1.4
Histori	-	-	-	Hist-Gjeo-Ed.qyt	12	Histori	7	Shkenca shoqërore	5	Edukim shoqëror, politik dhe mjedisor	10	Shkencat shoqërore	4.9
Gjeografi	-	Arte dhe Edukim fizik	27	Edukim fizik dhe sporte	12	Qytetari dhe studime shoqërore	2	Edukim fizik	8	Edukim artistik	7.5	Gjuhë e huaj e parë	11.3
Art dhe dizejnim	-			Edukim Artistik	6	Gjuhë e huaj (Anglisht)	7	Arte	9	Edukim fizik	5	Edukim Fizik	7.4
Muzikë	-	Gjuhë huaj	9	Gjuhë e huaj	12	Gjuhë e huaj 2	5	Gjuhë e huaj e parë	11	Edukim fetar dhe moral	5	Edukim Artistik	11.3
Qytetari	-	Gjuhë me zgjedhje	-	Gjuhë të tjera	12	Fizikë	4	Gjuhë të tjera	16	Këshillim dhe orientim	2.5	Feja dhe etika	3.5
Gjuhë e huaj	-	Ekonomi shtëpiake	3	Teknologji	7	Kimi	2	Feja	6			Teknologji	4.2
Teknologji dhe dizejnim	-	Feja dhe Etika	5			Gjeografi	4					Kurrikulë e lirë	6.3
Edukim fizik		Këshillim	2			Fizikë	4						
TIK						Edukim fizik	8						
Edukim fetar						Muzikë	3						
						Arte	3						
						Ekonomi shtëpiake	3						
						Shkenca kompjuterike	3						
						Teknologji	2						
						Edukim fetar	5						

TABELA 4 – AMU

Fusha të të nxënit ose lëndët dhe raporti mes tyre në AMU

Kanada		Kore		Kosovë		Poloni		SHBA		Slloveni		Shqipëri	
Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU % 6-9	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %	Fushat e të nxënit/lëndët	AMU %
Arte të gjuhës	-	Gjuhë koreane	12	Komunikimi dhe të shprehurit	25	Gjuhë polake	14.8	Arte të gjuhës angleze	-	Gjuhë sllovene	15.7	Gjuhët dhe komunikimi	26.5
Arte	-	Edukim moral	4	Matematikë	20	Histori	6.3	Matematikë	-	Matematikë	15.7	Matematika	14
Frëngjisht	-	Shkenca shoqërore	9	Shkencat	10	Edukimi qytetar	3.1	Studimet shoqërore	-	Gjuhë e huaj	13	Shkenca natyrore	16
Matematik	-	Matematikë	11	Shoqëria dhe mjedisi	10	Gjuhë e huaj moderne	9.5	Shkenca	-	Arte pamor	3.9	Shkencat shoqërore	17.5
Edukim fizik dhe shëndetësor	-	Shkenca	10	Shëndeti dhe mirëqenia	15	Matematikë	12.7	Shëndeti	-	Muzikë	3.9	Edukim fizik	7
Shkencë dhe teknologji	-	Arte praktike	7	Jeta dhe puna	10	Fizikë dhe astronomi	4.2	Arte	-	Gjeografi	7.2	Edukim artistik	10
Studime sociale	-	Edukim fizik	7			Kimi	4.2	Muzikë	-	Histori	7.8	Gjuhë e huaj e parë	-
Kanadaja dhe bota	-	Muzikë	3			Biologji	4.2	Edukimi fizik	-	Qytetari , Edukim patriotik dhe Etik	2.6	Gjuhë të tjera	-
		Arte të bukura	3			Gjeografi	4.2			Fizikë	5.2	Teknologji	2
		Gjuhë të huaja - anglisht	9			Art të bukura/Muzikë	3.1			Kimi	5.2		
		Veprimtari opsionale	3			Teknologji	2.1			Biologji	4.6		
		Veprimtari ekstrakurrikulare	3			Studime kompjuterike	2.1			Shkenca natyrore	3.9		
						Edukim fizik	12.7			Metoda dhe Teknologji	2.6		
						Orë mësimi me mësuesin kujdestar	3.1						
						Edukim fetar/Etikë	6.3			Edukim Sportiv	7.8		
						Orë mësimi me mësuesin kujdestar	3.1						

SHTOJCA 3

Tabela 9 Përqindja e kurrikulës me zgjedhje në planin mësimor

	Angli	Finlandë	Francë	Greqi	Gjermania (North Rhine- Westphalia)	Itali	Irlandë	Kosovë	Kanada (Alberta)	Kore	Poloni	Siloveni	Shqipëri
Arsimi fillor	-	16	-	16	4.7	20	7	10.6	15	6.5	13	-	5.4
Arsimi mesëm i ulët	-	29	8-24	9	7	20	17.5	13.5	20	9	13	9	5.4

BIBLIOGRAFIA

Crisan Assessment of the curriculum for basic education

Council of Ministers of Education, Canada. Canadian Commission for UNESCO. "The Development of Education Reports for Canada. Report One: The Education Systems in Canada – Facing the Challenges of the Twenty-First Century. Report Two: Inclusive Education in Canada: The Way of the Future." October 2008. Web. Prill 2011.

Eurydice Unit, Italy. Response to official EURYDICE Network enquiry GB (L) 97 004 00 on the definition of key skills. Unpublished document. Cituar nga INCA <<http://www.inca.org.uk/italy-sources-mainstream.html#24>>

Eurydice. "Recommended annual taught in full time compulsory education in Europe 2009 -2010, Eurybase - Descriptions of Education Systems, Structures of education, National Education System Descriptions." Web. Prill 2011.

Eurydice. "The System of Education in Poland." Warsaw 2008.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Organization of the Educational System in Greece 2009/2010."

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in Europe". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in Finland". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in Germany". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in Poland". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in France". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Vocational Guidance Education in Full-Time Compulsory Education in Slovenia". January 2009.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "New Skills for New Jobs". December 2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Organization of education system in Italy". 2009/2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "Organization of education system in Germany". 2009/2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. The organisation of the education system in England, 2009/2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "The organisation of the education system in France". 2009/2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "The organisation of the education system in Ireland". 2009/2010.

Eurydice. Education Audiovisual & Culture Executive Agency (EACEA). European Commission. "The organisation of the education system in Slovenia". 2009/2010.

Eurydice. European Commission. "National system overviews on education systems in Europe and ongoing reforms. National system overviews on education systems in Europe and ongoing reforms. Germany." July 2010.

INCA "International Trends in Primary Education, INCA thematic seminar" në 2003 në Oxford. Le Métails, J. International Trends in Primary Education. INCA Thematic Study No. 9. June 2003. London: Qualifications and Curriculum Authority.

INCA. "Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective. Country Description: Italy. International Review of Curriculum and Assessment Frameworks Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective." Web. Prill 2011.

INCA. "Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective. Country Description: Ontario. International Review of Curriculum and Assessment Frameworks Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective." Web. Prill 2011.

INCA. "Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective. Country Description: Germany. International Review of Curriculum and Assessment Frameworks Thematic Probe. Primary Education: an International Perspective." Web. Prill 2011.

International Bureau of Education. Canada. Profile of the education system made available through the database World Data on Education (WDE). Web. Prill 2011.

<http://www.ibe.unesco.org/en/worldwide/unesco-regions/europe-and-north-america/canada/profile-of-education.html>>

Le Métails, J. "International Trends in Primary Education." INCA Thematic Study No. 9. June 2003. London: Qualifications and Curriculum Authority.

MASH. Plani mësimor i arsimit 9–vjeçar. 2010-2011.

Ministero della Pubblica Istruzione. "Indicazioni per il curricolo." Roma - Agosto 2007.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. "Korniza e Kurrikulimit për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Drafti i dytë." Prishtinë, prill 2010.

Ontario Ministry of Education. "Elementary Progress Report Card." Web. Prill 2011.

Ontario Ministry of Education. 2004. "The Ontario Curriculum Grades 1–12. Achievement Charts (Draft)."

Ontario Ministry of Education. Web. Prill 2011. <<http://www.edu.gov.on.ca/fre/curriculum/elementary/grades.html>>

Ontario. Ministry Of Education (2000a). "Elementary Curriculum: Kindergarten - Grade 8 (Update Fall/Winter)" cituar nga INCA <<http://www.inca.org.uk/1207.html#5.2.5 Key skills>>

Qualifications and Curriculum Development Agency (QCDA). "England National Curriculum." Web. Prill 2011 <<http://curriculum.qcda.gov.uk>>

Sargent, C. e të tjerë. "Thematic Probe. Curriculum review in the INCA countries." June 2010. NFER.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2004-2015.